



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 MARS 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. MARTA 2018. GODINE**

**MARS - MART
2018**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-026 për azil,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-037 për metrologji,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-011 o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije,
2. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-025 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-225 o državnom tužilaštvu, izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 05/L-034,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-021 o unutrašnjoj kontroli javnih finansija,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-026 o azilu,
5. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-036 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima,
6. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-029 o zaštiti od zračenja i o nuklearnoj sigurnosti,
7. Drugo razmatranje Nacrt zakona br.06/L-032 o računovodstvu, finansijsko izveštavanje i reviziju,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-037 o metrologiji,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona br.06/L-041 o tehničkim zahtevima o proizvodima i proceni konformiteta,
10. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-031 o opremi pod pritiskom,
11. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-039 o Geološkoj službi Kosova.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: E fillojmë seancën e re plenare, të përgatitur për sot, më 30 mars 2018.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Albulena Haxhiu, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Më fal, zoti kryesues, jemi dakorduar që zoti Sami Kurteshi, si kryesues i grupit punues për Projektligjin për parandalimin e konfliktit, t'i prezantojë amendamentet, pastaj nëse ka nevojë do të inkuadrohem edhe unë.

KRYESUESI: Atëherë, zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 57.1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars e ka shqyrtuar Projektligjit numër 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Komisioni ka krijuar grupin punues, e grupi punues për shqyrtimin e këtij ligji ka mbajtur një diskutim publik, si edhe ka mbajtur disa takime me shoqatat, me shoqërinë civile dhe me grupet e interesit, në këtë kuadër edhe me organizatat ndërkombëtare që kanë shprehur interesim për shqyrtimin e këtij projektligji.

Natyrisht që grupi punues, bashkë me komisionin kanë nxjerrë tekstin më të mirë të mundshëm në këtë moment, edhe pse nga të gjithë ata që kanë punuar në grup punues dhe në komision është dhënë vërejtja se ligjet e tilla, me një vlerë të tillë, nuk do të duhej të shqyrtoheshin me një shpejtësi kaq të madhe për shkak të mungesës së kualitetit dhe mungesës së kohës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve.

Megjithatë, grupi punues dhe komisioni kanë vendosur që seancës t'ia paraqesin këtë projektligj dhe t'i rekomandojnë që të miratohet në seancë.

Në këtë projektligj janë 37 amendamente, të cilat i ka miratuar komisioni, në mesin e tyre është vetëm një amendament, amendamenti numër 25, i paraqitur nga deputetët Albulena Haxhiu dhe Ismajl Kurteshi, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Ky amendament nuk shkon në emër të komisionit, edhe pse gjatë trajtimit të amendamentit vërtet në parim jemi pajtuar të gjithë se bën ndryshime, është një amendament i shkurtër, i qartë dhe i saktë, me një porosi të qartë, mirëpo nuk e ka votuar komisioni për ta trajtuar si amendament të komisionit.

Megjithatë, mendoj se propozuesit e amendamentit mund ta arsyetojnë amendamentin, përndryshe Komisioni për Legjislacion i rekomandon seancës, pas rekomandimit edhe të komisioneve të tjera funksionale, që ta miratojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të komisioneve të përhershme. Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kërkoj falje, kryesues, unë si deputet e kërkoja fjalën, se nuk dëgjova. Si deputet e kërkoja fjalën.

KRYESUESI: Përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, thashë, pastaj më vonë ju. Nuk ka të paraqitur.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, dëshiron fjalën dikush, nuk e dëshirojnë.

Përfaqësuesi i Qeverisë, nuk e dëshiron fjalën. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë desha ta tërheq vërejtjen, po sigurisht komisioni mund ta ketë apo grupi punues mund ta ketë një shpjegim, pavarësisht që kjo po duket që po shndërrohet në praktikë.

Vetë ligji apo projektligji i ka 26 nene, ndërsa këta para Kuvendit kanë paraqitur 37 amendamente. Sipas praktikave të hartimit të legjislacionit, mbi 40% të ndryshimit konsiderohet ligj i ri, këtu është edhe sponsorizuesi, edhe ministri i Drejtësisë, po nëse këta pajtohen që ky ligj nuk e humb përmbajtjen dhe logjikën e ligjit, sipas asaj, atëherë mendoj që mund të jetë problematik në implementim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e dëgjova fjalën e zotit Zemaj, nëse shihet për nga numri i amendamenteve, mund të ketë formalisht të drejtë në aspektin kuantitativ.

Mirëpo të gjitha amendamentet nuk janë të natyrës përmbajtjesore, ka edhe të natyrës gjuhësore që sqarojnë ose heqin lëshime gjuhësore që janë vërejtur në tekst.

Grupi punues edhe komisioni, me gjithë kohën e shkurtër, kanë punuar nen për nen, paragraf për paragraf. Unë edhe një herë i falënderoj të gjithë ata që kanë bashkëpunuar në këtë drejtim, edhe ne kemi bërë përpjekje ta bëjmë punën më të mirë.

Prandaj, numri i amendamenteve në këtë formë nuk paraqet edhe ndonjë ndryshim përmbajtjesor që do të arrinte në 40% të ndryshimit të përmbajtjes së ligjit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjen e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk ka kolegë të tjerë të lajmëruar për debat.

Në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar gjithsej 36 amendamente.

Ndërsa nga deputetët Ismajl Kurtesh dhe Albulena Haxhiu është propozuar amendamenti numër 25.

Jemi në votimin e amendamenteve të propozuar me mirëkuptimin e seancës deri te amendamenti 25, do të thotë 36 amendamente, përveç amendamentit 25, në qoftë se kemi përkrahjen e seancës, i votojmë përnjëherë.

Memli Krasniqi, urdhëro, fjala për ju.

MEMLI KRASNIQI: Kisha propozuar, zoti kryetar, edhe si në rastet e seancës së kaluar që të shkojmë prej amendamentit 1 deri te amendamenti 24, pastaj amendamentin që s'e ka mbështetjen e komisionit dhe pastaj të vazhdojmë me amendamentet e tjera, nëse bën. Sepse kemi nevojë të diskutojmë për njërin prej amendamenteve, që është amendamenti 26, paraprakisht për sqarim. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, në qoftë se pajtohemi, unë i kisha vënë në votim nga 1 deri 24 menjëherë, të gjitha amendamentet votohen përnjëherë, pastaj nga 25 e shohim në bazë të vendimmarrjes suaj.

Po shoh që nuk ka reagim, po përgatitemi për votim.

Amendamentet 1 deri 24 votohen të gjithë përnjëherë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar, të gjitha votat janë për. Miratohen.

Amendamenti 25.

Me propozimin e deputetes Albulena Haxhiu dhe Ismajl Kurteshi, të dytë e kanë kërkuar fjalën, në të njëjtën kohë. A dëshironi të dytë të flisni. Urdhëro, zonja Haxhiu, pastaj zoti Kurteshi të bëhet gati.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Besoj që edhe zoti Ismajl Kurteshi do të kontribuojë për mbrojtjen e këtij amendamenti, por së pari disa sqarime.

Në mandatin e kaluar, dy herë radhazi Komisioni për Legjislacion kur draftonte, pra kur bënte amendamentet e Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, e ka paraparë edhe këtë amendament, të cilin e kemi propozuar ne si deputetë me mbështetjen e grupit parlamentar.

Por dallimi në atë kohë ka qenë që Komisioni për Legjislacion e draftonte dhe e merret mbështetjen e Komisionit për Legjislacion, por pastaj kur vinim në seancë parlamentare, Qeveria e tërhiqte pikërisht për shkak të këtij amendamenti.

Amendamenti në fjalë, për hir të transparencës dhe atyre që po na ndjekin, është ky:

“Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve kur është i caktuar sipas detyrës zyrtare”, dhe pse është përpiluar ky amendament, natyrisht besoj që secili prej jush mund ta dini.

Ne sot kemi zyrtarë që kanë dy, tri, katër, pesë, madje deri në gjashtë vende pune, sipas Agjencisë Kundër Korrupsionit, pra kemi zyrtarë supermenë që mund t’i bëjnë gjashtë punë brenda të njëjtës kohë, madje.

Kemi po ashtu deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës që në të shumtën e herëve nuk janë këtu, janë nëpër universitete duke ligjëruar apo diku tjetër.

Mendoj që ka ardhur koha që kjo të përfundojë dhe ky është qëllimi i amendamentit, të cilin e kemi propozuar ne si grup parlamentar.

Unë shpresoj që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta mbështetin një amendament të tillë, sepse është jashtëzakonisht shumë i nevojshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kurteshi, fjala për ju.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Propozimi im dhe i deputetes Albulena Haxhiu është që nenit 12, pas paragrafit 2, t'i shtohet edhe një paragraf i ri, përmbajtjen e të cilit e lexoi zonja Haxhiu, unë nuk dëshiroj ta përsëris, por arsyeja pse është propozuar ky amendament, unë do t'i përmend dy më të rëndësishme.

Së pari, secili zyrtar i lartë ka aq shumë punë sa që nuk ka kohë të lirë që të angazhohet edhe në një vend tjetër pune. Angazhimi edhe në një vend tjetër pune ose edhe në 5-6 vende të tjerë të punës, siç po ndodhë këtu te ne, shkon në dëm të detyrës kryesore që e ka si zyrtar i lartë, prandaj të gjithë zyrtarëve të lartë nuk do të duhej t'u lejojnë një gjë e tillë, sepse ato vende i zënë jo për shkak të meritës, por për shkak të keqpërdorimit të pozitave që i kanë.

Nganjëherë ky është edhe konflikt i drejtpërdrejtë interesi. Na ka ndodhur shpesh që ministri i Arsimit, për shembull, punon nëpër kolegje të ndryshme dhe në asnjë mënyrë nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe një farë lloj mbikëqyrësi, derisa në të njëjtën kohë është edhe i varur nga punëdhënësi i tij, pra nga pronari i kolegjit dhe kësi raste kemi shumë edhe në shëndetësi dhe tjetërkund.

Arsyeja tjetër pse nuk duhet një zyrtar i lartë të angazhohet edhe në një vend tjetër të punës, është se në Kosovë kemi me mijëra të rinj që kanë kryer fakultetet, po presin me vite që të punësohen dhe nuk kanë mundësi të punësohen për shkak të mungesës së vendeve të punës, të vetmen gjë që ata po e presin është liberalizimi i vizave dhe ikja nga Kosova për një vend të ri.

Prandaj, unë i kisha lutur të gjithë deputetët që ta votojnë këtë amendament dhe kështu do të kontribuonin që zyrtarët e lartë të jenë më produktivë në vendin e tyre të punës dhe të lirojnë vende të punës për ata të cilët janë të papunë. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën, edhe Muharem Nitaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Jo rrallë herë ka qenë temë debatit edhe përkufizimi, a më mirë ta quaj kufizimi i ushtrimit të një funksioni në sektorin publik në raport me funksione politike apo që kjo që ne po i quajmë 'zyrtarë të lartë publikë'.

Unë mendoj që nuk duhet të merren praktikata e këqija apo shembuj të këqij kur hartojmë një legjislacion.

Duhet më mirë të fokusohemi në shembuj të mirë dhe në kualitetin e ligjit, mbi të gjitha, edhe në kualitetin e institucionit.

Personalisht po flas pa ngarkesë, sepse nuk ushtroj detyrë tjetër në sektorin publik, edhe nuk kam mungesa në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por kjo do të linte një shije të keqe, ta quaj, kushtimisht, në kandidaturat e ardhshme, edhe në kufizimin që e kanë deputetët, sidomos këta që i kemi këtu të nivelit akademik, të shkencës, e të mjekësisë, sportit, kulturës e të tjerë.

Po mendoj që ligji duhet të mbetet ashtu siç është, është qartë përkufizimi kur e kufizon mundësinë e ushtrimit të një funksioni dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk duhet të implikohet në këto tema, mbi të gjitha duhet ta ruajë edhe pavarësinë, sepse janë të zgjedhur të qytetarëve, mbi të gjitha janë të besuarit e qytetarëve ta ushtrojnë mandatin sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit.

Për mendimin tim, kjo nuk duhet të përkrahet në mënyrën se si është, sepse shumë e kufizon, nuk e qartëson dhe nuk e dallon edhe pjesën e sektorit publik.

KRYETARI: Muharrem Nitaj e ka fjalën, ndërkohë të bëhen gati Hajdar Beqa, Ismajl Kurteshi, Shkumbin Demaliaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë personalisht do ta mbështesja këtë amendament, mirëpo kam përshtypjen që amendamenti ka disa paqartësi.

Propozuesi e ka sqaruar me gojë, e kuptova bukur mirë, por, në fakt, në pjesën e shkruar shkruan ndryshe, thuhet: “Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se sa një funksion në sektorin publik”, a e merr shembull sektorin privat, ndërkohë që në këtë amendament e ka përjashtuar sektorin privat.

Dhe flet që zyrtari i lartë nuk mund të ketë më shumë se një punë, ndërkohë që këtu flet për funksion dhe nuk jam shumë i sigurt nëse puna mund të konsiderohet si funksion.

Prandaj, kam përshtypjen që amendamenti ka paqartësi dhe do të ishte mirë propozuesi që ta specifikojë, ta saktësojë, në mënyrë që të mos kemi dilema nëse do të duhej ta votonim ose jo. Faleminderit!

KRYETARI: Shkumbin Demaliaj, Hajdar Beqa.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit!

Ne edhe në komision e kemi shqyrtuar edhe këtë amendament të paraqitur nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Me të vërtetë, ky amendament i jep kuptimin këtij ligji dhe e ka vendin në këtë ligj. Mirëpo paraqitja rreth kësaj është se kur mundohet të arsyetohet, flet për njerëzit që janë mandatarë, të zgjedhur. Ne nuk e kemi mandatin vend pune këtu, personalisht edhe unë e ndaj të njëjtën çështje me deputetët që folën më herët, se nuk ushtroj ndonjë funksion tjetër përveç atij të deputetit.

Mirëpo, ku t'i marrësh që t'i kemi krejt profesorë a doktorë në Kuvend. Ne kemi folur gjithçka për të inkorporuar në Rregullore dhe si do të jetë puna jonë me Rregulloren në Kuvend. Ndoshta atëherë kur deputetët nuk mund të jenë ta votojnë a ta trajtojnë atë temë për t'i votuar brenda një dite ligjet, dhe të gjitha çka i kemi në Kuvend.

Mirëpo ne kemi pasur raste kur vetë Gjykata Kushtetuese lidhur pikërisht rreth këtij amendamenti ka vepruar pozitivisht ndaj të ankuarve lidhur me këtë çështje.

Edhe unë i kam propozuar atë ditë, i kam thënë do ta keni mbështetjen, nëse vetëm pasuesi i fundit të bëhet "sipas ligjeve në fuqi", sepse ka ligje të tjera që bien në kolizion me këtë ligj që japin mundësinë, e jo çdo ditë të ketë raste në kuadër të shërbimit civil apo në tema të tjera që një njeri duhet ta lëshojë një vend pune, e pikërisht atë e fiton nëpërmjet gjykatës dhe po bëhet kolizion dhe praktikë e dyfishtë e këtij mekanizmi që ne po mundohemi ta nxjerrim para qytetarëve si arsyetim.

Pikërisht për atë kemi qenë kundër në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa, Bilall Sherifi, pastaj në fund propozuesit kanë kërkuar prapë fjalën, në qoftë se s'ka deputetë.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

T nderuar ministra,

Deputetë,

Qytetarë,

Realisht, e thanë edhe kolegët, komisioni e ka shqyrtuar dje në mbledhjen që ishte Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Edhe grupi punues e ka kryer një punë shumë të mirë, kemi parë se shumë amendamente, të cilat u diskutuan, ka pasur dëgjim publik. Kurse sa i përket amendamentit që është propozuar nga kolegët deputetë Ismajl Kurteshi dhe zonja Albulena Haxhiu, konsideroj që ky amendament bie edhe në kundërshtim me Kushtetutën.

Kemi pasur raste kur edhe mjekët i janë drejtuar, ndoshta nuk është krejt ekuivalente, po i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka dalë vendimi në favor të mjekëve.

Unë i ftoj kolegët deputetë që t'i përkrahin të gjitha amendamentet e komisionit, po jo amendamentin e deputetëve Kurteshi dhe Albulena Haxhiu, vetëm çka kanë kaluar në komision kërkoj t'i votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, fjala për ju. Pastaj, në qoftë se nuk ka të tjerë deputetë, unë në fund e përfundoj me propozuesin.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mora fjalën për të thënë atë që e kam thënë edhe në mbledhjen e komisionit.

Mendoj që ideja që pretendon të rregullojë ky amendament, në fakt është rregulluar me disa ligje të tjera.

Tentimi që përmes këtij amendamenti të shkurtohet mënyra, rruga, mjetet për t'i detyruar njerëzit, ata të cilët kanë nga 2,3,4 apo 5 funksione publike, nuk mendoj që është rruga e duhur, e kam thënë në komision, po e them edhe këtu.

Edhe pse i kam premtuar koleges se po, votën time do ta jap, nuk është problemi te vota ime, sepse në parim unë e mbështes idenë që të mos ketë më shumë se një vend pune, eventualisht 50% të kohës brenda 24-orëshit të mund të punojë edhe në një vend tjetër, por jo 5-6, sepse askush nuk mund të jetë në 3,4,5,6 vende në të njëjtën kohë. E nëse nuk mund të jesh në të njëjtën kohë në tre vende të ndryshme, atëherë nuk mund edhe t'i kesh apo t'i ushtrosh tri përgjegjësi publike, tre vende të punës, as në sektorin publik, po as në atë privat, nuk mund t'i kesh.

Meqë ligjet në fuqi e rregullojnë këtë çështje, për shembull, çdo kush që bën një kontratë mbi bazë të një ligji, me një vend pune në sektorin qoftë publik, qoftë privat, ai detyrohet të qëndrojë aty tetë orë në punë dhe nëse është në një vend të punës, nuk mund të jetë në vendin tjetër. Pra, rrjedhimisht del se e kemi të rregulluar çështjen së paku një e më së shumti, pas orarit të punës, edhe 25 apo 50%, ai i cili dëshiron të ketë vetëm jetë profesionale dhe kurrfarë jete tjetër, as familjare, as private.

Duke pasur parasysh, po e ritheksoj atë që kjo çështje thashë është e rregulluar, mendoj që tentimi që përmes një ligji të vetëm të pamundësohet punësimi apo zënia e vendeve të punës, të disa vendeve të punës në sektorin publik, është rrugë jo e duhur. Mendoj që ne duhet të shkojmë në drejtim të forcimit të rendit dhe të ligjit, sidomos zbatimit të ligjeve që e rregullojnë këtë çështje dhe të mos tentojmë që këtë ta rregullojmë duke e shtuar një nen në një ligj, siç është Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit.

Unë personalisht kam thënë që, meqë në parim e mbështes, do ta votoj, por nuk mendoj që është zgjidhje për problemin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Nezir Çoçaj, ndërkohë u lajmërua, të bëhemi gati për proces të votimit, kolegët që e kanë propozuar edhe një herë e kanë fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa për njoftim, ne e kemi diskutuar në komision dhe në parim nuk është mbështetur, edhe pse ideja e propozuesve të këtij amendamenti është praktike dhe e mirë, mirëpo me ligj nuk guxojmë ta sanksionojmë dikë që do të punojë përveç punës primare, me ligjin aktual lejohet edhe puna sekondare.

Në anën tjetër, zakonisht çdo organizatë në shtetin tonë, edhe Kuvendi, po edhe institucionet e tjera qeverisëse synojnë dhe dëshirojnë ta kenë një person që ka gradë sa më të lartë shkencore, në mënyrë që aftësitë profesionale të tij të jenë më të mëdha, duke i pasur parasysh punëtorët e tjerë që konkurrojnë në një konkurs publik, po ku nuk kërkohet një gradë e lartë shkencore.

Po ashtu në secilin shtet të botës kjo është e lejuar, bile nuk e kanë të kufizuar as në dy vend të punës, mund t'i kenë 10, 12, 13, mirëpo aty kërkohet vlerësim i performansës, edhe me ligjin aktual çdo organizatë në Kosovë e ka për obligim që në fund të vitit të bëjë vlerësimin e performansës së çdo punëtori të saj. Këtu që është mirë të mos sanksionohet duke e bllokuar këtë mundësi që dikush me afinitet e dëshiron të punojë, të ketë hapësirë dhe mundësi të punojë edhe në një vend tjetër të punës, duke përfshirë si normë sekondare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shqipe Pantina, kush lajmërohet, ka të drejtë të flasë.

SHQIPE PANTINA: Ne deshëm vetëm një sqarim, se këtu diskutimet po fliten sikur po bëhet fjalë për vend pune, për derisa amendamenti po kërkon të mos ketë dy funksione.

Unë mendoj që është një dallim mes funksionit publik dhe një vendi pune që dikush mund ta ketë edhe në sektorin publik. Për shembull, të jesh doktor në një spital nuk është funksion, është një vend pune profesional, përderisa funksione, të paktën ashtu siç definohen me ligj, unë shpresoj se propozuesit të na sqarojnë edhe një herë se çfarë kanë nënkuptuar.

Është më tepër diçka që nuk lidhet domosdoshmërisht me profesion, me ushtrim të profesionit, siç është, ta zëmë, puna e deputetit, sepse deputeti nuk është profesion, është funksion.

Prandaj, shpresoj dhe lus propozuesit që ta sqarojnë a e kishin fjalën për funksionet publike apo edhe për vendet e punës, të cilat janë të lidhura me profesionin dhe nuk kanë të bëjnë me detyra të tjera që dalin nga profesioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Disa sqarime.

E para, po shoh që ka një ngatërrësë të madhe kur po flitet për këtë amendament, është mirë që deputetët të lexojnë së pari se çka rregullon ky ligj.

Është Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit. Pra, është kështu është titulli i këtij projektligji. Dhe, kur flitet për zyrtarët e lartë nuk janë vetëm deputetët. Është prej një drejtori të një departamenti deri te Presidenti. Është Ligji për deklarimin e pasurisë që i rregullon saktësisht se kush janë zyrtarë të lartë dhe, edhe dje në komision kemi pas debat lidhur me këtë. E para, kur ne jemi të zgjedhur ta zëmë, ose bartim funksione publike, tash qytetarët na zgjedhin neve për ta ushtruar atë funksion. Ta zëmë, qytetarët i zgjedhin deputetët për t'i përfaqësuar në Kuvend, ministrat në Ekzekutiv ta zëmë, por ka edhe raste të tjera të shumta, prandaj, edhe kur mbart funksion publik, natyrisht që ka edhe përgjegjësi të tjera dhe po, dikush mund të mbetet keq, po çka të bëjmë tash.

Kuvendi është vendi ku rregullohen dhe adresohen këto çështje. Meqë kemi probleme të shumta në këtë drejtim, prandaj edhe ka lindur nevoja për ta adresuar me këtë amendament dhe tjetra, kur thuhet që është në shpërputhje me Kushtetutën, a bën të na tregoni se me cilin nen të Kushtetutës është në shpërputhje? Sepse, kur ky Kuvend e ratifikoi Marrëveshjen që fal territor, pse asnjëherë s'u përmend Kushtetuta kur u fal territori, e po përmendet Kushtetuta me një amendament që mund t'i prishë punë dikujt këtu në këtë sallë të Kuvendit. Dhe tjetra, vendimi i Gjykatës Kushtetuese është mirë të mos thirret më në atë vendim për këtë rregullim për shkak se ai ka të bëjë me angazhimin në sektorët privatë, dhe Gjykata Kushtetuese atë e ka adresuar dhe nuk ka të bëjë me këtë çështje që sot po e shqyrtojmë.

Prandaj, është mirë të mos luajmë as me vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe i ftoj deputetët, të cilët po e përmendin shumë Kushtetutën, le të na bëjnë të qartë se cilin nen të Kushtetutës e shkel ky amendament. Edhe një herë po e kërkoj mbështetjen e deputetëve të Kuvendit për këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Hajdar, a ta ka përmendur emrin që e kërkoje fjalën? Jo! Hajdar, të gjithë po thonë jo! A t'ia jep Albulenë fjalën, replikë po kërkon Hajdari? Në fjalim po thotë! Veç ta qartësojë temën, se ju keni për të votuar në fund, ne në fakt. Hajdar, merre fjalën për replikë, dhe shkojmë në votim.

HAJDAR BEQA: Kryetar, faleminderit!

E kemi analizuar, i kemi dëgjuar edhe palët e interesit, thashë është në kundërshtim me Kushtetutën, respektivisht me kapitullin për liritë themelore të të drejtave të njeriut. Kurse, sa i përket formës, qysh po e shpjegon zonja Albulena Haxhiu, i bie që edhe prej kryetarit të partisë, Albini duhet të japë dorëheqje, të mbetet deputet, ose secili kryetar nëse merr funksion. Nuk është e sqaruar mirë, nuk i kontribuon këtij ligji ky nen tash. Ligjet janë të rregulluara, kjo çështje është e rregulluar edhe me ligje tjera, prandaj unë mendoj që duhet ta hedhim në votim dhe t'i përkrahim amendamentet, të cilat i ka përkrahur komisioni, e jo amendamentet e deputetëve, sepse e prishin esencën e ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Dardani, Ismajl i fundit je, dhe futemi në votim. Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Unë po dua ta shpërfaq një rast që mendoj ky amendament e trajton shumë mirë. Në asambljetë komunale, përkatësisht në Prishtinë, ka asamblistë, edhe në të kaluarën ka pasur asamblistë dhe ministër. Dhe, asamblisti ka qenë në opozitë në nivel komunal, ndërsa ministër në pozitë në nivel qendror, dhe ka pasur konflikt të drejtpërdrejtë interesi në vendimet që i ka marrë, e kjo është njëri prej momenteve ku kemi probleme. Ndërsa, në anën tjetër, paradoksin e keni kur një deputet nuk mund ta ushtrojë detyrën të themi të një drejtori në komunë. Pra, hajde ta kemi këtë frymë që të mos krijojmë këso lloj situatash, kur duke i ushtruar dy funksione publike jemi në konflikt të interesit të drejtpërdrejtë.

Unë jam pro këtij amendamenti dhe grupi ynë do ta votojë për.

KRYETARI: Faleminderit! Sami, Ismajlit jepja se s'po dalloni, bile me mbiemër fare. Sami, pastaj Bekim a e do fjalën që e kërkoje?

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë megjithatë i dëgjova kolegët dhe koleget dhe mendoj që krejt shqetësimet e ngrehura janë me vend, por ajo që nuk më duket me vend është citimi ose thirrja në disa gjëra që nuk mund të qëndrojnë.

Nën një, ne e kemi diskutuar, natyrisht që unë thashë në parim jemi pajtuar, mirëpo ky amendament nuk e prek Kushtetutën. Merreni nenin e Kushtetutës që ka të bëjë me punën, nuk e ndalon punën dhe nuk e ndalon përzgjedhjen.

E dyta, flitet për përvojat e ndryshme në botë. Unë nuk e di kush çfarë përvojash ka, por unë po e them që sa më të zhvilluara vendet në botë, aq më mirë është e rregulluar kjo çështje dhe aq më pak është e lejuar që të mbahen dy funksione nga zyrtarët e lartë, sepse dy funksionet e një zyrtari të lartë bien me dashje ose pa dashje në konflikt të drejtpërdrejtë të interesit.

Dhe, çështja e tretë, unë megjithatë e kam udhëhequr grupin punues dhe në çdo takim të grupit punues dhe të komisionit, megjithatë të komisionit jo, sepse unë s'kam qenë udhëheqës i komisionit, kam kërkuar nga të gjithë të pranishmit që të deklarohen në mënyrë shprehimore nëse kanë ndonjë konflikt të interesit në lidhje me ndonjë nga normat e këtij ligji që po trajtohet. Edhe unë mendoj se secili duhet ta shohë veten a ka konflikt interesi me normat e këtij ligji, po ashtu edhe me këtë normë ose amendament që është propozuar nga deputetët Albulena Haxhiu dhe Ismajl Kurteshi, në emër të “Vetëvendosjes”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bekim Haxhiu e ka fjalën, Ismajli e përmbledh dhe shkojmë në votim.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e kisha në plan të diskutoj për këtë amendament, sepse edhe gjatë draftimit të këtij ligji kam qenë i bindur, sepse amendamenti është tërësisht politik dhe ka qëllim vetëm bërjen politikë me këtë amendament ,e jo rregullimin e një fushe të caktuar, për atë për çka bëhen ligjet, sepse diskutimet më bindën që amendamenti edhe më tutje është vërtet politik, sepse iu referuan rasteve politike, rasteve kur një subjekt politik apo subjekti tjetër politik ka analizuar, ose e ka parë këtë çështje prej pikëpamjes së vet politike, jo që ta zgjidhë një problem.

Do të thotë, me këtë amendament ne këtu si deputetë do t'ua ndalojmë disa prej doktorëve të hyjnë në sallat e operacionit për të shpëtuar jetë, do t'ua ndalojmë disa profesorëve eminentë t'u mbajnë mësim nxënësve dhe studentëve dhe t'u kërkojmë që në ulëset e Parlamentit të mos vijnë më njerëz intelektualë, profesorë e doktorë të shkencave, doktorë e njerëz humanistë, por këtu të ketë më shumë rrugaçë ose njerëz niveleve të tjera, të cilat i përfaqëson propozuesi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi të kam edhe në parti, e kam një replikë, krejt çka bëjmë këtu është politikë. A është kështu, Sami? Krejt politikë është. Ismajl, tash përmbledh dhe shkojmë në votim, në qoftë se pajtohemi të gjithë.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Së pari i kisha lutur deputetët që ta shqyrtojnë këtë propozim pa paragjykime. Krejt është politikë, por ky e ka një synim pak më ndryshe se ç'po e shohin disa deputetë që diskutuan. Dhe, po ashtu për ata që, ose s'e kanë lexuar amendamentin, ose s'e dëgjuan kur e lexoi Albulena, bëhet fjalë për zyrtarët, amendamenti fillon kështu: “zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik”. Prandaj, nuk bëhet fjalë për secilin të punësuar, por vetëm për zyrtarët e lartë dhe mendoj që këta zyrtarë të lartë, nëse u intereson dhe janë akademikë për të qëndruar atje në atë botën akademike, mirë është të qëndrojnë atje, e të mos vijnë këtu, sepse as atje s'kanë për të kryer punën si duhet, e as këtu.

Dhe, po ashtu, mendoj se deputeti është me mandat dhe atij i lejohet të kthehet në vendin e punës nëse është përcaktuar për të ardhur për deputetë, le të vijë edhe doktorët e shkencave, edhe të gjithë ata, sepse Kuvendi nuk është për rrugaçë, por është për njerëz që e meritojnë ta përfaqësojnë popullin dhe kur ta kryejnë mandatin me ligj u lejohet të kthehen në vendet e tyre të punës. Disa nga deputetët u brengosën që shkelet ligji. Besoni që po të shkelet ligji për këtë punë, edhe nuk ka ndonjë gjynah i madhi, po hiç mos u bëni merak se nuk shkelet ligji me këtë punë. Duke e refuzuar këtë amendament, të nderuar kolegë deputetë, ne po votojmë me vetëdije ose pa vetëdije për vazhdimin e një praktike që është këtu te ne e njohur që një njeri i ka uzurpuar 5-6 vende të punës, por në ato shkon vetëm të nënshkruhet sa për t'i marrë rrogat dhe nuk mund të punojë si duhet.

Ne jemi të gjithë dëshmitarë të rasteve kur dikush shkon shumë rrallë që ta mbajë ndonjë ligjëratë, e i dërgon asistentët, sepse ka shumë vende tjera të punës. Dikush shkon shumë rrallë të bëjë operacion, edhe pse s'ia ndalon kurrkush, sepse nuk ka kohë të shkojë për të bërë operacione, por të gjithë kanë kohë të shkojnë të nënshkruhen që t'i marrin rrogat. Prandaj, për ta luftuar këtë farë dukurie negative, me të cilën të gjithë ne po përballemi dhe kur bisedojmë kështu në katër sy, e pranojmë se kjo gjë nuk do të duhej të tolerohej, tash është momenti që këtë ta dëshmojmë me votën tonë dhe t'i ndërpresim këto praktika të dëmshme dhe të padrejta ndaj atyre që janë të kualifikuar, që janë të zotët të kryejnë punë, por nuk po vijmë në shprehje për arsye se disa zyrtarë të lartë po kanë nevojë për 5-6 rroga, por nuk mund t'i kryejnë 5-6 punë. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi, ndërkohë u lajmërua edhe Milaim Zeka. Ne do të kishim hyrë në votim, në bazë të Rregullores unë jam i obliguar t'ua jap fjalën, edhe pse çdoherë po mundohem ta thërras propozuesin në fund, por në ndërkohë u lajmëruan. Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Mendoj se ky amendament e ka idenë të mirë, por realizimi është i gabuar. Nëse ne këtu jemi për ta mbrojtur interesin publik, pikë së pari, mendoj se ky amendament e dëmton interesin publik. Po e marrim dhe po e përkthejmë në praktikë konkrete, nëse zyrtarët e lartë, po e zëmë deputetët, janë disa deputetë këtu që janë mjekë, kirurgë, nëse një kirurg i mirë është deputet, sepse i ka bërë 30 vjet në kirurgji dhe tash dëshiron t'i japë pak publikur prej një dimensionit tjetër. Ne ia ndalojmë atij kirurgu të punojë në spital publik. Pra, dëmtohet interesi publik dhe nëse ai për katër vjetët e ardhshme, një kirurg i mirë për katër vjetët e ardhshme nuk ka për të punuar në kirurgji, ai vdes si kirurg, merr fund, nuk është më kirurg.

Ose, do ta detyrojmë që të shkojë në sektorin privat, dhe ku është interesi publik? Ne këtu e dëmtojmë interesin publik. Ose një profesor, ose një akademik, ose një zyrtarë i lartë... Pra, kjo që është propozuar këtu është në dëm të interesit publik. Unë e kuptoj idenë dhe problemin që u përmend këtu se disa prej zyrtarëve të lartë publik kanë 3, 4 e 5 paga, shkojnë nënshkruhen e si i

marrin, ajo është çështje që rregullohet me mbikëqyrësin e vet, por jo ta ndalojmë me ligj, që të mund një kirurg i mirë të jetë edhe deputet, edhe të jetë në sektorin publik. Pra, ne po ia ndalojmë të jetë në sektorin publik. Po e obligojmë, ose të shkojë në sektorin privat, ose të pushojë 4 vjet. Pas katër vjetëve, një kirurg do të marrë fund. Prandaj, mendoj që është gabim si amendament dhe unë nuk e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim Zeka, përgatitemi për votim pastaj.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë personalisht e kam lexuar me shumë vëmendje amendamentin dhe në mënyrë të fuqishme e përkrah këtë amendament për arsye se ata njerëz, të cilët janë deputetë dhe mundohen të japin diçka për sektorin publik, ata veç e shkatërrojnë sektorin publik. Po e marr shembull Suedinë dhe po flas konkretisht për deputetin e Parlamentit suedez, Adnan Dibrani. Adnan Dibrani nuk ka të drejtë të punojë as në bankë suedeze ku e ka punën gjatë kohës që e ushtron mandatin e deputetit. Në qoftë se njeriu zgjedh të jetë deputet i Parlamentit të Kosovës, atëherë duhet ta llogarisë që prej ditës së hënë e deri të hënën tjetër, 24 orë është në punë, sepse duhet të lexojë ligje, duhet të miratojë ligje, prandaj unë personalisht edhe kolegët e mi i ftoj nga partia ime, nga “Nisma”, për arsye se shpeshherë kemi mendime individuale për amendamente, për gjëra të ndryshme, por në rastin konkret unë nuk kam parë amendament më të mirë, prandaj e ka mbështetjen time absolute. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 25, deputeti Ismajl Kurteshi dhe Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

73 deputetë kanë votuar, 32 për, 37 kundër, 4 abstenime. Nuk kalon!

Po e shoh edhe Besa Baftiu në të njëjtën kohë ka qenë për, atëherë shtohet një votë. Edhe ju Salih, a? Atëherë dy vota. Prapë nuk kalon me aq sa po e shoh. Besa Baftiu dhe Salih Salihu janë për. Futet në procesverbalin e votimit, por prapë nuk kalon amendamenti 25.

Amendamentet 26 dhe 27, Partia Demokratike e Kosovës ka kërkuar që të shprehë qëndrimin e vet. Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në lidhje me amendamentet 26 dhe 27, të cilat i referohen nenit 14 për anëtarësinë në organizata joqeveritare, ne i ftojmë deputetët që t'i votojnë kundër këto dy amendamente dhe në mënyrë që

të kthehet teksti ashtu siç e ka sjellë sponsorizuesi, pra Qeveria, dhe realisht është e njëjta situatë, e cila është edhe tash dhe siç ka qenë deri në këtë moment.

Meqenëse amendamenti propozon që asnjë nga qindra e qindra zyrtarë të lartë, e që ky numër është rritur nga viti në vit, që i nënshtrohen ligjit të cilin po e diskutojmë të mos jenë anëtarë të organizatave joqeveritare në organet e tyre drejtuese, ndërsa legjislacioni aktual dhe legjislacioni që është propozuar prej sponsorizuesit e pamundëson vetëm funksionin drejtues, por jo edhe anëtarësimin në organet drejtuese. Kështu që ne mendojmë që duhet të jetë ashtu siç ka qenë dhe siç është propozuar prej sponsorizuesit dhe për këtë u bëjmë ftesë deputetëve që amendamentet 26 dhe 27 t'i votojmë kundër në mënyrë që të kthehet teksti që ka qenë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një propozim konkret. Tani Sami Kurteshi, edhe dy deputetë e kanë kërkuar fjalën, ju lutem kush e kërkon fjalën paraqituni në mënyrë që të shkojmë në votim. Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e dëgjova kolegun me kujdes dhe pas diskutimeve të shumta edhe me shoqërinë civile, edhe me grupet e interesit, por edhe me njerëz që janë pjesëtarë të shoqërisë civile, e këtu kemi të bëjmë me organizatat joqeveritare, domethënë është fjala për organizata joqeveritare, ku Qeveria nënkupton, edhe shteti, nuk duhet të jenë në ato organe, në organizatat joqeveritare që marrin vendime për aktivitetet e këtyre institucioneve.

Në të vërtetë, organizatat joqeveritare janë të natyrave të ndryshme, por e kanë një thelb dhe thelbi është ky: personat fizikë, dedikimin në organizatat qeveritare e mbështetin në filozofinë e liberalizmit që e ndajnë kohën e tyre pa asnjë lloj ndikimi, qoftë edhe nga familja, një çështje që ka të bëjë me korrigjimin e veprimeve të shtetit dhe të Qeverisë. Çdo pjesëmarrje e një zyrtari në organet e larta të organizatave joqeveritare domosdo prek thelbin filozofik të veprimit të organizatave joqeveritare. Kjo ka qenë ideja, ky është qëllimi, ata mund të jenë anëtarë, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve vendimmarrëse, ose organeve drejtuese, siç quhen këtu. Ky ishte qëllimi i rregullimit të këtyre amendamenteve. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që neni 14 ka qenë shumë i qartë, e bën përkufizimin edhe për zyrtarin e lartë kur mund të jetë anëtar i organit drejtues, në çfarë kushtesh, ose në çfarë kriteresh, dhe sigurisht që kjo është pengesë sidomos për atë që ne equajmë veprimtari humanitare.

Shembull konkret, para disa dite, presidentja Jahjaga e proklamoi krijimin e një fondacioni humanitar, ku ajo tash nuk mund të jetë në organin drejtues. Lexojeni nenin deri në fund, mos e lexoni veç pjesën e parë, sepse neni lexohet prej fillimit deri në fund, jo vetëm njëra pjesë. Pjesa tjetër, kemi individë këtu që janë edhe në sallë, e kemi edhe njerëz ndoshta edhe nga subjektet që e kanë propozuar këtë që janë anëtarë të organizatave joqeveritare që merren me veprimtari shkencore edhe humanitare dhe nëse janë në organet drejtuese përjashtohen nga çdo implikim buxhetor, qoftë edhe nga përfitimet buxhetore, kështu që mos e prishni logjikën e nenit, sepse është përkufizuar shumë qartë. Unë nuk e di pse nuk po flet sponsorizuesi, apo edhe ata që ndoshta që janë marrë me veprimtarinë e OJQ-ve, që kanë përvojë edhe në këtë drejtim.

Unë nuk po shoh ndonjë pengesë, vetëm bëhet pengesë nëse largohen, zoti Kurteshi, nga organet drejtuese, sepse ai që e drejton, ai është themelues, ai e ka logjikën. Ai vetëm përjashtohet prej obligimeve buxhetore, financiare, dhe e ruan edhe karakterin e një OJQ-je, dhe e ruan edhe pikëpamjen e vet të ushtrimit të asaj veprimtarie, qoftë edhe zyrtar i lartë. Të mos harrojmë, se dikush e përmendi shkarazi, në Republikën e Kosovës nuk është zyrtari i lartë siç është në vendet tjera demokratike, sepse numri është më i kufizuar. Në zyrtarët e lartë, sipas Ligjit për deklarimin e pasurisë, i kemi futur edhe anëtarët e asamblesë dhe numri është diku me mijëra. Dhe atëherë, unë po flas për organizatat joqeveritare që kanë edhe kredibilitet dhe kanë emër në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

Në fakt, me atë që e thanë dy kolegët e mi, shefi i grupit parlamentar Krasniqi dhe Zemaj, unë jam dakord plotësisht që të votohet kundër amendamenteve 26 dhe 27. Nëse e shohim ligjin paraprak, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtari i lartë mund të ushtrojë pjesë nga fusha e shkencës, sportit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare. Po ashtu, po e përmend këtu edhe rastin, sepse në vetëm në Kuvend kemi deputetë që janë pjesë e organizatave joqeveritare, që e ushtrojnë këtë aktivitet pa pagesë, po e përmendi vetëm zonjën Brovina që pjesë e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, e po ashtu edhe deputetët tjerë dhe atë që e tha zoti Zemaj që edhe vetë presidentja Jahjaga aktualisht e ka krijuar një fondacion, nuk jam që t'ua minojmë aktivitetin humanitar zyrtarëve të lartë ku ata dëshirojnë të jenë pjesë e ndonjë mekanizmi të tillë.

Prandaj, kërkoj që të votohet kundër amendamenteve 26 dhe 27.

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Desha vetëm ta bëj një sqarim. Në komision, përveçse në grup punues, ku është diskutuar goxha gjatë me përfaqësues të shoqërisë civile, e kemi diskutuar edhe në komision, dhe aty ky amendament është përkrahur unanimisht. Tash, Grupi

Parlamentar i PDK-së po thërret që të mos përkrahet. Është mirë që ta kemi njëfarë koordinimi ndërmjet shefit të grupit parlamentar me përfaqësuesit që i kanë në Komision për Legjislacion, sepse ata veten s'e përfaqësojnë.

Prandaj, unë e mora fjalën për të thënë që ta votojmë propozimin e Komisionit për Legjislacion, i cili është përkrahur unanimitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Unë e mora fjalën veç për ta falënderuar zonjën Haxhiu, do ta kemi parasysh në të ardhmen këtë këshillë tepër të vlefshme dhe do të mundohem se është shumë më mirë me anëtarët e grupeve punuese të koordinohemi për çështje të tilla, por, sidoqoftë, seanca duhet të vendosë në fund, pavarësisht qëndrimeve të atyre anëtarëve që i kemi aty.

KRYESUESI: Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!
Në fakt, disa prej kolegëve i dhanë sqarimet.

Neni i propozuar si amendament është paksa i paqartë, sepse, ta zëmë, një deputet në të njëjtën kohë, pa paragjykim, mund të jetë një person me aftësi të kufizuara dhe ai ka të drejtë që të jetë anëtar i organizatës që përfaqëson interesin e, ta zëmë, personave me aftësi të kufizuara, ose një shembull tjetër, deputetë apo zyrtarë të tjerë që mbajnë pozita të ndryshme mund të jenë, ose mund të kenë pasion për mbrojtjen e mjedisit dhe mund të jenë anëtarë në organizata që mbrojnë mjedisin. Ajo çfarë nuk është e qartë këtu, është se këtu thuhet: të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare. E tash, disa organizata organ drejtues e kanë Kuvendin e disa të tjera e kanë bordin. Unë jam dakord që zyrtarët e lartë nuk mund të kenë pozita menaxhuese brenda organizatave joqeveritare, por jo “të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese”, siç thash mund të jenë edhe kuvendet apo mund të jenë edhe bordet e të cilat nuk kanë funksion ekzekutiv në ushtrimin e detyrave të përditshme.

Kështu që, unë mendoj se një kufizim i tillë nuk duhet t'u bëhet zyrtarëve, veçanërisht kur puna e tyre është kryesisht pa pagesë dhe nuk ka të bëjë me menaxhimin dhe ekzekutimin e detyrave brenda një organizate joqeveritare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,
Kryesues dhe kolegë deputetë të nderuar,

Vetëm sa për sqarim, sepse me sa kam kuptuar unë këtu po bëhet një përzierje e vogël në mes anëtarësimit në organizata joqeveritare të zyrtarëve të lartë dhe mbajtjes së pozitive udhëheqëse, që është qoftë anëtari i bordit në fondacione apo anëtar i Kuvendit në shoqata, sepse këto janë dy llojet e OJQ-ve që lejohen në Kosovë.

Krejt ideja e organizatave joqeveritare është që të mos ketë vendimmarrje në to nga ana e qeveritarëve e përfaqësuesve të Qeverisë. Kështu që, unë mendoj se ky amendament është në atë frymë, që të ndajë organet, ose përfaqësuesit e Qeverisë nga veprimtaria e OJQ-ve, prapë kjo nuk e ndalon në asnjë mënyrë kontributin që mund ta japin zyrtarët e lartë nëpërmjet anëtarësisë. U përmendën disa lloje të ndryshme, qofshin ato me kufizime apo edhe të tjera që janë rekreacionale, por ideja është këtu që, me sa kam kuptuar unë, edhe në grup punues edhe që është përfaqësuar nga përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, është që të mos ketë ndikim nga ana e politikës dhe nga ana e zyrtarëve tjerë të lartë, që ndoshta nuk janë drejtpërdrejtë në politikë, në vendimmarrjen e organizatave joqeveritare.

Thënë atë, unë nuk e shoh ndonjë problem nëse kjo realizohet, sepse pikërisht shkon në frymën e lirisë së asociimit dhe shkëputjes njëherë e përgjithmonë të organizatave joqeveritare nga ndikimi i Qeverisë, qoftë qendrore, lokale apo edhe efekteve politike, që po i shohim aty.

Vetëm sa për fjalë të fundit, një numër i madh i OJQ-ve që janë serioze, janë kredibile, në fakt në statutet e tyre e kanë një dispozitë që nuk lejon anëtarësimin e zyrtarëve të lartë në organet qeverisëse, qoftë bordet në fondacione apo kuvendet në shoqata. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë përsëri po e marr fjalën, s'po dua ta zgjas, mirëpo unë po i dëgjoj diskutimet edhe ka një përzierje të gjërave dhe koncepteve. Megjithatë, organizatë joqeveritare në thelb do të thotë organizatë që ka të bëjë, merret, me çështje të cilat nuk i mbulon qeveria dhe shteti. Në mënyrë vullnetare ua dedikojnë kohën, punën dhe të gjitha mjetet e tyre një çështjeje që në të vërtet nuk mbulohet, ose herë-herë mund të jetë edhe kundër vendimeve qeveritare dhe shtetërore. Kjo është çështja.

Askund, në asnjë moment, nuk përmendet ndalimi i anëtarësimit, qoftë edhe i zyrtarëve të lartë, në organizata joqeveritare që janë të lejuara me ligj në një shtet. Mirëpo, këtu kërkohet që zyrtarët e lartë të përjashtohen nga mundësia për të qenë anëtarë të organeve drejtuese, do të thotë menaxhuese edhe vendimmarrëse, por jo të jenë edhe anëtarë të organizatës, ku mund ta japin kontributin e tyre. Mandej, kemi raste për shembull, te zonja ish-presidente, që tash paska krijuar një fondacion, mirëpo zonja ish-presidente tash nuk ka funksion aktiv. Kjo është çështja. Dhe, vendimet e saj nuk kanë karakterin e vendimeve të organeve shtetëror. Tash ne mund të

themi edhe ashtu. Unë jam që secili prej nesh të jetë i anëtarësuar në një organizatë, që cilësohet këtu arsimore, humanitare, sportive, kulturore..., por të mos jetë anëtar i organeve drejtuese apo vendimmarrëse, sepse ne mund të ndihmojmë, qoftë me përvojën, qoftë me mjetet, qoftë me punën tonë, por jo të jetë në ato organe dhe të ketë një funksion tjetër, që mund të bien, edhe bien shumë lehtë, në konflikt interesi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa dhe pastaj shkojmë në proces të votimit.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Një sqarim desha ta jap për amendamentin 26 dhe 27. Është e vërtetë që Komisioni për Legjislacion dje ka qenë shumë i ngarkuar. Gjatë gjithë ditës kemi qenë edhe në grupe punuese, dy ligje të cilat ishin në agjendën e projektit ERA. Unë isha më shumë edhe i koncentruar në ligjin ku isha udhëheqës i grupit punues të Prokurorisë së Shtetit.

Për opinionin publik, amendamenti 26 dhe 27 nuk janë amendamente të propozuara nga sponsorizuesi, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës, por janë nga grupi punues. Realisht, unë tash e kam analizuar më mirë në grup, në komision na ka ikur kjo. Konsideroj se ligji bazë ku është anëtarësia në organizata joqeveritare është më e kompletuar, sepse me këto dy amendamente, nëse i lëmë siç janë këtu, atëherë i ndalojmë edhe veprimtaritë e lira, siç është shkenca, arsimit, sporti apo çështje humanitare. Mbështes kryetarin e grupit, zotin Krasniqi, dhe i ftoj deputetët që këto dy amendamente t'i votojnë kundër dhe të mbetet teksti bazë, siç është në nenin 14 në ligjin e vjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi propozim konkret. A i vendosim, zoti Krasniqi, të dyja bashkë apo veç amend... Urdhëro, urdhëro fjalën, më mirë. Zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Është amendamenti 26 i Komisionit për Legjislacion dhe unë ju ftoj që ta vendosni këtë amendament në votim.

KRYETARI: Po, po, unë e vendos në votim, në qoftë se... kështu vetëm ishte ideja. Në qoftë se nuk kalon, atëherë shkon ai bazë, apo kjo... Po!

Atëherë, jemi në amendamentin 26. A lejoni t'i lidhim të dy?

26 dhe 27 votohen bashkë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Është e komisionit, në qoftë se kalon e komisionit, mbetet e komisionit, s'kalon – kalon alternativa origjinale, ajo e cila ka sjellë propozuesi, përkatësisht Qeveria.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë amendamentet 26 dhe 27. Votojmë tash!

Me 73 vota, 18 për, 49 kundër, 6 abstenime. Nuk kalon propozimi i Komisionit Funkcional. Kthehet ai i propozuesit.

Amendamentet 28 – 37 a ka mundësi t'i vë përnjëherë në votim? Përgatitemi për votim. Me përkrahje të Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar. 72 për, 1 kundër, 2 abstenime. Kuvendi miratoi Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ke të drejtë plotësisht, kërkoj falje. Nganjëherë edhe... Kërkoj falje, amendamentet kaluan. Kërkoj falje, faleminderit për ndërhyrje. Amendamentet kaluan në këtë formë të votimit nga 28 – 37.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar, 54 për, 2 kundër, 19 abstenime. Kuvendi miratoi Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetaren e komisionit, zonjën Albulena Haxhiu, ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion në pajtim me nenin 57, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.03.2018, e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe vendosi që për shqyrtim të këtij projektligji Kuvendit t'ia paraqesë këtë raport.

Janë 6 amendamente, por çështja qëndron që në disa prej amendamenteve ka dy propozime. Janë disa propozime të deputetit Korab Sejdiu, që besoj se secilin prej tyre do ta arsyetojë, por po ashtu edhe janë propozime që i kam deponuar unë, si përfaqësuese e “Vetëvendosjes”. Prandaj, edhe në secilin amendament ku ka nga dy propozime është mirë që të arsyetohen nga propozuesit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, do të shkojmë me atë procedurë. Janë 6 amendamente në këtë projektligj, do të shkojmë me votimin e tyre një për një.

Amendamenti 1 ka dy propozime, është ai i Komisionit Funkcional dhe i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. A dëshiron deputet ta marrësh fjalën për ta arsyetuar? Urdhëro!

KORAB SEJDIU: Përshëndetje edhe një herë!

Në koordinim me grupin parlamentar vlen të potencohet se në agjendën evropiane në këtë projektligj është rekomanduar vetëm përmbajtja që gjendet në nenin 2. Vetëm ajo që gjendet në nenin 2, do të thotë lehtësimi i kriterëve për caktim në prokurorinë speciale, mirëpo çka ka ndodhur është se janë shtuar edhe disa dispozita të tjera të këtij projektligji, përfshirë këtu edhe nenin 1, që i ka dy paragrafë. Për paragrafin 2 do të flasim te amendamenti 2.

Ne kemi pasur nevojë për sqarim nga sponsorizuesi, përkatësisht nga iniciuesi i kësaj, që ka qenë zyra e kryeprokurorit të shtetit dhe në fakt, varësisht se kush ka ardhur prej asaj zyre nuk e ka pasur të qartë se çfarë kanë kërkuar. Pasur parasysh që këtu kemi të bëjmë me një shtim të një kompetence goxha serioze për kryeprokurorin e shtetit, e kemi menduar se nuk është koha dhe nuk është mënyra e duhur për ta trajtuar në këtë projektligj, veçanërisht duke pasur procedurën e përshpejtuar. Nëse vërtet besohet që një kompetencë e tillë duhet t'i jepet kryeprokurorit, atëherë le të bëhet me procedura të rregullta, po mbi të gjitha të dihet qartë se çfarë synon zyra e kryeprokurorit të ketë në bazë kësaj kompetence shtesë.

Unë prapë po e theksoj, që varësisht, ne e kemi pasur përfaqësuesin e Zyrës së kryeprokurorit në disa raste, edhe në komision, edhe në grup punues, dhe varësisht cili prej tyre ka ardhur, kanë dhënë interpretime të ndryshme, sa i përket kësaj dispozite. Kështu që, nuk besoj se është në të mirë të vendit, që ne si deputetë të votojmë diçka që ka kuptim, të cilin varësisht cili anëtar i zyrës së kryeprokurorit të shteti e lexon e interpreton ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqaj, e përfaqëson Komisionin Funkcional.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Komisioni për Legjislacion në pajtim me nenin 57 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës më datë 29.03.2018 e ka shqyrtuar Projektligjin 06/L-25 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-225 për Prokurorinë e shtetit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-34 dhe vendosi që për shqyrtimin e projektligjit Kuvendit dhe komisionit kryesor, domethënë t'ua paraqesë dhe komisionit t'ua paraqesë për rekomandim për votim Kuvendit. Unë si kryesues i grupit punues të Ligjit për prokurorinë e shtetit kam diskutuar me të gjitha palët i kemi dëgjuar

ka pasur edhe dëgjim publik për të gjitha çështjet dhe edhe sponsorizuesi, në këtë rast, Ministrinë e Drejtësisë, por edhe me Prokurorinë dhe ftoj deputetët që të votohen vetëm propozimet që kanë marrë mbështetjen e Komisionit FunkSIONAL.

E tha edhe zoti Sejdiu, e bëri sqarimin e amendamenti tash që kemi një që i ka dy propozime, po propozimi i komisionit është më i kompletuar, sepse propozimi i deputetëve në këtë rast apo i deputetit e cungon apo ia humb kuptimin, sepse edhe me ligjin bazik kryeprokurori e ka me ligj me ia caktua lëndën prokurorëve apo me ua marrë i ka tri arsye kur ua merr, me ua caktua deri në 30 ditë. Ne kemi menduar edhe Prokuroria po edhe Këshilli Prokurorial dhe Ministria e Drejtësisë, që asnjë prokuror nuk mund për 30 ditë ta shqyrtojë një lëndë. Dhe me këtë e ka të drejtën kryeprokurori t'ia japë një lëndë, t'ia caktojë një prokurori tjetër një vit, maksimumi deri në dy vjet. Mendoj se është në interes të ligjit dhe në interes të zgjidhjeve të lëndëve që të mbetet ajo siç është edhe e propozuar nga komisioni dhe nga ministria, të gjitha amendamentet. Faleminderit!

KRYETARI: Po, po, avash se janë edhe të tjerë kolegë. Në fund ia japim propozuesit çdoherë, jo, jo, jepi edhe replikë. A po do më mirë në fund e arsyeton dhe shkojmë në votim. Kjo është punë... më mirë është në fund çdoherë e arsyeton edhe kryetarja e komisionit ka kërkuar fjalën. Zotëri Kurteshi, pastaj në fund për propozimin e vet, kur para se ta hedh në votim variantin e propozuar nga deputeti, e thërras prapë deputetin ta marrë fjalën. Regjia, kryetarja e Komisionit, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Po, e përmendi edhe zoti Sejdiu që ne e kemi diskutuar goxha shumë këtë nen nga sponsorizuesi. Pra, sipas Ministrisë së Drejtësisë është propozuar që kryeprokurorit të shtetit t'i jepen kompetenca shtesë të hetimit dhe ndjekjes penale, domethënë kjo në kuadër të detyrës së tij prokuroriale.

Duhet pasur të qartë, që aktualisht me ligjin në fuqi, që është neni 11, paragrafi 2, kryeprokurori i shtetit ka të drejtë që të marrë çfarëdo lëndë në secilën prokurori vetëm se duhet ta arsyetojë a po e merr për shkak të neglizhencës apo e merr për shkak të konfliktit të interesit apo paaftësisë dhe joprofesionalizmit të një prokurori. Pra, kjo aktualisht është në fuqi dhe mendoj se mirë si komision, në mandatin e kaluar, e kemi adresuar këtë çështje.

Tash, mua po më duket goxha arbitrare në qoftë se nuk e kemi të qartë, se përse po i duhet edhe kjo kompetencë shtesë? Ne kemi provuar edhe dje të marrim informacione se cili është qëllimi, por besomëni që ka dallime të mëdha edhe në diskutime me prokurorë që përfaqësojnë zyrën e Aleksandër Lumezit, në këtë rast kryeprokurorit të shtetit. Pozita e kryeprokurorit të shtetit është pozitë menaxheriale dhe shtimi i kësaj kompetence pa asnjë arsyetim të bazuar, për bindjen time, është goxha problematike, sepse mund të jetë arbitrare në qoftë se kryeprokurori i shtetit mund

ose e merr një lëndë pa asnjë arsytim të bazuar, siç thekson Ligji për prokurorin e shtetit i cili është në fuqi.

Dhe e dyta, që ka të bëjë me propozimin e zotit Sejdiu, sepse po mundohem në të dy amendamentet ta arsyetoj qëndrimin e grupit parlamentar tani, është shkelje e Kushtetutës, për shkak se Kushtetuta e specifik qartë që Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucioni apo organi kompetent për të rekrutuar, propozuar, emëruar, riemëruar, prokurorët. Pra, kjo është kompetencë ekskluzive e njohur sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nëse shohim në tërësi projektligjin, ka një tendencë për ta dobësuar Këshillin Prokurorial që është organ kushtetues dhe sipas Kushtetutës i pavarur dhe për ta fuqizuar një individ. Mendoj që, kjo nuk duhet lejuar. Andaj, unë i ftoj deputetët e Kuvendit që t'i mbështetin dy propozimet, pra dy amendamentet e deputetit Korab Sejdiu. Dhe, në fund po shtoj që edhe Instituti i Kosovës për Drejtësi, por po ashtu edhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike na kanë shkruar neve si deputetë dhe kanë kërkuar që të mos përkrahet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë, por që kjo kompetencë të hiqet me amendamente, siç ka propozuar deputeti Korab Sejdiu. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi. Le të bëhet gati Armend Zemaj, pastaj Hajdar Beqaj në emër të grupit punues për sqarim të shkurtër dhe pastaj Korab vendos a do tash ta marrësh fjalën apo kur të futet vetëm variacioni juaj. Tash, jo, jo e vendos, të pyes unë prapë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i dëgjova me vëmendje edhe kolegun Korab Sejdiu. Interpretimi i tij është i drejtë dhe është interpretim, edhe logjik, edhe ligjor, edhe shkencor, edhe nga përvoja. Po, edhe nga ajo që kemi dëgjuar ne, vërtet ne kemi pasur paqartësi në lidhje me këtë çështje nga vetë Zyra e Prokurorit. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë, që po dua ta ngre megjithatë si frymë në këtë Kuvend është një përpjekje e akumulimit të pozitive nga zyrtarët e lartë. Ne e pamë, domethënë kërkesa që të mos ketë dy pozita të funksionarëve publikë në sektorin publik, të zyrtarëve të lartë, ka të bëjë pikërisht me këtë fenomen. Largimi i zyrtarëve të lartë nga organet drejtuese dhe vendimmarrëse të shoqërisë civile ka këtë kuptim. Përpjekja dhe interpretimi i deputetit Korab Sejdiu në lidhje me akumulimin e funksioneve të kryeprokurori i shtetit e ka këtë kuptim dhe ky kuptim, nëse i shohim në mënyrë të përbashkët, në të vërtetë ka të bëjë me atë që edhe në raporte të progresit po edhe në shumë raporte të tjera, quhet “kapje e shtetit”. Edhe ky fenomen, me dashje, ose pa dashje, po shfaqet në normat ligjore të ligjeve, që po i nxjerrim pikërisht për ato çështje apo ato organe, që në të vërtetë duhet ta luftojnë këtë dukuri.

Mua kjo po më shqetëson shumë, sepse kemi të bëjmë me dy çështje që nuk përputhen. Shumë herë unë dëgjoj nga kolegë dhe kolege të mija, thonë “unë në parim pajtohem me këtë, por votoj

kundër”. Çka do të thotë kjo? E në anën tjetër, thotë: “hajde e votojmë ligjin në parim, edhe pse s’pajtohemi me të.” Unë mendoj se mirë është që ne të gjithë të mendojmë rreth këtyre deklaratave tona. Ne jemi këtu. Për mua nuk dëshmon ndikimi, shantazhimi i drejtpërdrejtë te deputeti, por për mua deklarata të tilla janë të mjaftueshme për të menduar se dikush pajtohet në parim me një çështje, por voton të kundërtën. Kjo mua më lejon të dyshoj edhe në krejt atë që quhet “ndërgjegje politike” e deputetit. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj, urdhëro! Bëhet gati Bilall Sherifi, pastaj janë propozuesit.

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryetar!

Unë e kam kështu një lloj debati me anëtarët e komisionit, sepse ky debat duhet të bëhet në Komisionin Funkcional për të vetmen arsye, sepse është logjika e ligjit, janë dy mendime të ndara. Unë kam biseduar shumë gjatë edhe me Korabin, tash po i dëgjoj këtu edhe kolegët deputetë.

Atëherë, pse është sjellë Projektligji për prokurorin e shtetit. Nëse mbizotëron logjika që ne nuk duhet ta fuqizojmë ose Kuvendi vendos që të mos e kemi një kryeprokuror me kompetenca të shtuara nga ato që s’i ka pasur, atëherë duhet të vijmë në shprehje, po këto duhet të analizohen mbi bazën e cilës arsye ka ardhur deri te shtimi i kompetencave. Sepse ne mund të pengojmë në pjesë të tjera apo në amendamente të tjera që janë si pjesë përmbajtësore e projektligjit.

Personalisht, unë nuk e shoh me emër kryeprokurorin e shtetit, po e shoh një kryeprokuror të shtetit, i cili e avancohet sundimin e rendit të ligjit në vend dhe mbi të gjitha e lufton krimin dhe korrupsionin apo edhe i vë në funksion prokurorët e Prokurorisë së Shtetit në Republikën e Kosovës.

Nga ajo çka kemi parë deri tash dhe çka është thënë gjithmonë, ne kemi një Prokuror të Shtetit për shkak të kompetencave dhe për shkak të mospasjes qasje ligjore të menaxhimit, atëherë kemi edhe mosefikasitet në luftimin e dukurive apo veprave të rënda penale në Republikën e Kosovës.

Kështu që unë i kisha lutur anëtarët e komisionit, sepse kjo nuk është vetëm çështje debati apo edhe asaj duke parë individin tash që e udhëheq, kryeprokurorin e shtetit.

Kemi të bëjmë me një amendament, i cili është shumë i rëndësishëm që ka të bëjë qoftë me kompetenca, qoftë me bartjen e lëndëve, qoftë në funksion të prokurorëve të cilët janë në mandatin e tij.

Kështu që me këtë mënyrë debati nuk e zgjidhim ne sot, mund edhe të vijmë deputetët e Kuvendit në njëfarë lajthitje, të mos e quaj, kushtimisht, por është ndarje në mendime edhe në koncepte se si e shohim zyrën e kryeprokurorit të shtetit.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në komision është e vërtetë që kemi qenë të ndarë, bile dy herë i kemi thirrur në komision edhe nga Këshilli Prokurorial, edhe nga Prokuroria, kështu që kemi pasur debate në komision dhe është e vërtetë që nuk kemi arritur të gjithë të jemi njëzëri apo të bindemi nga argumentet që na janë dhënë aty.

Dhe, këtu vijmë te ajo pika që e tha kolegu Kurteshi, se njeriu duhet të votojë me ndërgjegjeje politike, po nganjëherë kur nuk të bindë dot ai i cili e kërkon ndryshimin dhe nuk të bindë as ai i cili reziston, kundërshton ndryshimin, natyrisht që pastaj deputeti mund të ketë luhatje dhe mund të mos jetë i vendosur se cila do të jetë mënyra më e mirë për ta rregulluar këtë.

Tash po e them atë që e kam thënë edhe në komision, mendoj se si ka funksionuar kryeprokurori teri më tani e kemi parë, përmes rregullimit të vjetër e kemi parë dhe e dimë, pra është një film që e kemi parë, e dimë se si funksionon, çka bëhet si bëhet, si zhvillohet. Ky propozim i ri na sjell në një situatë të cilën nuk e dimë, nuk kemi ide se si do të zhvillohet ajo, çfarë pasojash qoftë për të mirë, qoftë për të keq mund të ketë ndryshimi i këtij, ta quaj ashtu, i kësaj kompetence, miratimi i këtij amendamenti dhe pajisja e kryeprokurorit edhe me kompetenca për të filluar, pra që të jemi të qartë, për të filluar, për të zhvilluar hetime dhe për të aktakuzë, madje edhe për të mbrojtur në seanca gjyqësore aktakuzën, të cilën e ngre për cilindo rast.

Unë e kam shtruar atëherë pyetjen, prapë po e shtroj edhe në seancë, siç e kam shtruar në komision. Kush do të kryejë punët e menaxherit të kryeprokurorit në kohën kur kryeprokurori, sepse këtu supozohet që kryeprokurori do të marrë për vete raste të rënda, që kërkojnë orë të tërë, ditë të tëra, javë të tëra voluminoze pune, seanca të gjata gjyqësore, të stërzgjatura, kush do ta menaxhojë Kryeprokurorinë.

Apo cilës do t'i japë më shumë rëndësi personi, cili do që do të jetë nesër kryeprokuror. Nuk mendoj që këtu ka deputetë që kur debatojnë për ligje, ka parasysh personin që është duke ushtruar funksionin, nuk merremi me personin. Personi sot mund të jetë i dhuri apo i gabuari, nesër mund të jetë super i gabuari, nuk e dimë varet, nuk dimë gjithmonë se çka na sjell e ardhmja.

Por unë edhe sot mendoj që jam i sigurt cila është mënyra më e mirë, se cila është rruga më e drejtë, se cila mënyrë, sido që ta rregullojmë, e kaluara apo kjo e tashmja apo e ardhmja, do të bëjë më efikase luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Sepse na është thënë kur kemi biseduar për këtë çështje se ka të bëjë me ngritjen e performansës në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, sidomos kur ka të bëjë me raste të rënda, pra me raste për të cilat supozohet se prokurorët më të vegjël nuk kanë guxim apo kurajë për të filluar. Kjo është arsyeja mbi të cilën e

kanë bazuar kërkesën për të ndryshuar këtë dispozitë dhe për të pajisur kryeprokurorin edhe me këtë kompetencë.

Prandaj, unë u thashë edhe kolegëve të mi të “Nismës”, kjo është çështja e cila kërkohet të ndryshohet.

Meqë unë vetë nuk jam i bindur, nuk mund t’i them askujt silluni kështu apo mos u sillini kështu, votoni për apo votoni kundër, le të votojnë sikur ata të besojnë se cila është rruga më e mirë, pra le të votojnë ashtu siç besojnë.

Nëse besojnë se kjo, siç ka qenë, është e mjaftueshme, le ta lënë kështu, nëse mendojnë se përmes ndryshimit të kësaj dispozite, përmes pajisjes së kryeprokurorit me këtë kompetencë, do të ngritët niveli i luftës kundër këtyre dukurive, atëherë le ta votojnë. Pra, le të mbetet në ndërgjegjen politike, në bindjen politike të deputetit, në besimin e deputetit se cila është mënyra më e mirë për të votuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fund, para procesit të votimit. Tani kërkoj vëmendjen tuaj. Hajdar Beqa, ne do të shkojmë në votim pas fjalës tuaj. Korab, janë dy alternativa, dy variacione, shkojmë në votime të ndara, të krijojmë mundësinë. Hajdar Beqa flet tani për Komisionin Funkcional, ti menjëherë pas tij amendamentin të cilin e ke propozuar vetë.

Hajdar Beqa, shkojmë në votim, vëmendje!

HAJDAR BEQA: Kryetar, një sqarim për opinionin dhe për deputetë, ky nen dhe ky amendament nuk i prek kompetencat e Këshillit Prokurorial. Këshilli Prokurorial propozon, rekruton, avanco, transferon edhe disiplinon sipas ligjit për prokurorët.

Kurse me këtë nen cakton prokurorët, edhe me ligjin bazë, me ligjin që është aktual, në fuqi, kryeprokurori e ka kompetencë t’i caktojë prokurorët për një lëndë, t’ua marrë një lëndë e t’i japë një prokurori tjetër për një afat 30 ditë.

Ne kemi thënë në kuptimin profesional, kush është jurist, e kupton, që nuk ka mundësi një prokuror një lëndë për 30 ditë ta shqyrtojë.

Propozimi i prokurorit, i Këshillit Prokurorial dhe i Ministrisë së Drejtësisë është të mbetet ashtu qysh e ka propozuar komisioni.

Andaj, unë i ftoj deputetët që të votohen të gjitha amendamentet që kanë marrë votimin e komisionit. Ka qenë i qartë shumë, nuk di çka thanë këtu kolegët, një pjesë, edhe Këshilli

Prokurorial, edhe Zyra e Prokurorit, edhe Ministria e Drejtësisë kanë qenë shumë të qarta, tash sa i kemi kuptuar ne, sa nuk i kemi kuptuar, është çështje krejt tjetër.

Nuk ka kuptim ndryshimi i këtij ligji pa i bërë këto ndryshime. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Vjosë, po tash jemi në proces. Urdhëro!

VJOSA OSMANI: Nuk po flas për përmbajtjen e propozimeve, qoftë të komisionit, qoftë të deputetit Korab Sejdiu, edhe pse natyrisht që e përkrah atë që e tha Korabi.

Megjithatë edhe në ligjin paraprak, edhe në këtë ligj po i dëgjojmë kolegët tanë vazhdimisht duke paragjykuar që kolegët e tjerë deputetë nuk i kanë lexuar amendamentet apo nuk e kanë lexuar ligjin, edhe thonë nuk e keni lexuar, edhe na e kërkojnë votën për ato amendamente.

Ju kisha lutur, mos më me paragjykime të tilla. Kaq desha.

KRYETARI: Shkojmë në votim, është amendamenti i parë, propozimi i Komisionit Funkcional votohet.

Urdhëro, Korab! A e dëshiron tash fjalën, dy votime janë, mos keqkupto, a dëshiron tash, merre fjalën, Urdhëro!

KORAB SEJDIU: Kryetar, votimi i dytë s'ka kuptim, nëse kalon i pari, kështu që për atë është e rëndësishme ta kem fjalën tash.

Sa për sqarim, unë besoj krejt deputetët e kanë lexuar ligjin, kështu që përkraheni amendamentin tim.

Mirëpo është e rëndësishme të kuptohet, se sikur është përzier këtu, filluan të bisedojnë për amendamentin 2, ne jemi ende duke folur për amendamentin një, që i ka dy propozime.

Amendamenti 2 ka të bëjë me atë çështjen antikushtetuese për caktim të prokurorëve.

Tash jemi duke folur a t'ia shtojmë një kompetencë a jo, propozimi 1 b, që është propozimi i bërë nga grupi ynë, është që të lihet ligji si është aktualisht në fuqi, domethënë kryeprokurori mund të marrë një lëndë, por vetëm në raste specifike sipas nenit 11.2 kur ka neglizhencë, paaftësi profesionale ose konflikt interesi nga prokurori që e ka lëndën.

Nëse aprovohet propozimi në amendamentin 1 a, do të thotë i shtohet kryeprokurorit një kompetencë shtesë, të cilën nuk e ka dhe të cilën, varësisht cili përfaqësues na ka ardhur, i ka

dhënë kuptim të ndryshëm. Do të thotë, qëllimi im është që të lihet neni në fuqi që është aktualisht dhe nëse ne mendojmë ta fuqizojmë kryeprokurorin e shtetit, atëherë e bëjmë atë si vendim politik, po jo si diçka që ndodh me një dispozitë që mund t'i jepen disa kuptime dhe që nuk e ka të qartë as ai që është i thirrur për ta zbatuar se çka duhet të zbatojë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë e kemi konsumuar debatin për amendamentin 1, do të shkojmë në dy variacione në votim.

Në rend të parë votojmë për amendamentin 1, varianti a, Komisioni Funkcional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 32 për, 42 kundër dhe 2 abstenime.

Jemi në variacionin e amendamentit 1, të propozuar nga Korab Sejdiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar, 46 për, 24 kundër dhe 4 abstenime.

Atëherë kalon amendamenti 1, propozimi i variacionit b.

Jemi në amendamentin 2, po ashtu i kemi dy propozime.

Komisioni Funkcional dhe deputetit Korab Sejdiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

A të shkojmë në votim?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, amendamenti 2, jemi në variacionin e Komisionit Funkcional, në rend të parë.

Korabi dëshiron të flasë para se të shkojmë në votim, ju lutem. Urdhëro, Korab! Amendamenti 2.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje,

Tash i ka ardhur radha amendamentit 2, që pak u diskutua nga disa parafolës kur ishte amendamenti 1.

Amendamenti 2, në fakt, ka të bëjë me paragrafin 2 të nenit 1 të projektligjit, i cili bie ndesh, siç është propozuar nga sponzoruesi, bie ndesh me nenin 110, paragrafi 2 të Kushtetutës që thotë:

“Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, do të propozojë, do të avancojë, do të transferojë, do të disiplinohet prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj”. Do të thotë, ligji e përcakton mënyrën se si Këshilli Prokurorial e bën regrutimin, propozimin, avancimin, transferimin apo disiplinimin e prokurorëve. Çka është kërkuar këtu është që t’i jepet mundësia kryeprokurorit që të caktojë Prokurorinë Speciale sipas nevojave urgjente për një vit, me mundësi vazhdimi edhe një vit shtesë.

Kjo, në fakt, bie ndesh me këtë nen, sepse kjo është kompetencë ekskluzive e Këshillit Prokurorial dhe nëse ne mendojmë t’ia japim këtë kompetencë kryeprokurorit, atëherë ne mund ta bëjmë këtë, po duhet iniciuar procedurat e rregulla për ndryshimin e Kushtetutës.

Dje është diskutuar, është përmendur fakti që aktualisht e ka këtë kompetencë me ligj për 30 ditë dhe unë nuk besoj që kalimi i një ligji që cenon pak Kushtetutën është bazë që të kalojë një ligj që e cenon atë edhe më shumë.

Ka pasur edhe indicie që të argumentohet se kjo është në përgjigje të nevojave dhe unë e di që ka nevoja ekstreme për të pasur fleksibilitet kryeprokurori i shtetit, mirëpo besoj që ne duhet të insistojmë që Këshilli Prokurorial të jetë më përgjegjës ndaj kërkesave të kryeprokurorit, e jo me vetëdije të cenojmë Kushtetutën, përkatësisht nenin 110, paragrafi 2, duke kaluar një ligj që mendojmë se e cenon Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prandaj, kërkoj nga të gjithë ju që të votoni kundër propozimit a të amendamentit 2 dhe të përkrahni amendamentin 2, b, do të thotë, propozimin e amendamentit 2 b, që e lë në fuqi ligjin aktualisht siç është. Faleminderit!

KRYETARI: Hajdar Beqa nga Komisioni Funkcional e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Kryetar, vetëm sqarim që ky nen nuk e cenon Kushtetutën, e thamë edhe më herët, realisht është te paragrafi 2 i nenit 1 në këtë rast, i amendamentit 1.

Këshilli Prokurorial dhe askund në Kushtetutë të Republikës së Kosovës nuk ka term ‘cenon’. E thashë më herët, mund ta përsëris, është e drejtë e deputetëve edhe me ligjin aktual kryeprokurori e ka këtë kompetencë, e ka në afat më të shkurtër kohorë, sponsoruesi, Këshilli Prokurorial dhe Prokuroria kanë menduar ta kenë një vit deri dy vjet mundësinë e shqyrtimit të lëndëve, caktimit të një prokurorit prej një lënde prej një prokuror në prokuror tjetër.

Kjo është e drejtë e deputetëve, por kërkoj që të përkrahet propozimi i komisionit, jo propozimi i deputetit. Faleminderit!

KRYETARI: Albulena Haxhiu, dhe jemi në votim.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

E theksoi zoti Sejdiu që propozimi i Ministrisë së Drejtësisë rrjedhimisht që është i përfshirë në amendamentin 2, propozimi a, pra i Komisionit Funkcional bie ndesh me Kushtetutën nen 110, paragrafi 2.

Duhet pasur parasysh që këtë kompetencë e ka Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe rregullimi aktual, pra ky standard kur i mbetet Këshillit Prokurorial të Kosovës të caktojë, të emërojë, të transferojë prokurorët siguron një proces transparent, i cili mundohet të siguroj një përzgjedhje meritor të të gjithë prokurorëve në vend.

Po luhet me fjalë këtu padrejtësisht dhe qëllimisht, Ministria e Drejtësisë e ka përdorur termin “caktim” dhe jo “transferim” apo terma të tjerë që i njeh Kushtetuta e Republikës së Kosovës, pikërisht për të mos ngritur diskutime që ky nen bie ndesh me Kushtetutën.

Prandaj, ne si grup parlamentar e mbështesim propozimin e deputetit Korab Sejdiu dhe, në anën tjetër, e kundërshtojmë propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Qeverisë dhe Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim.

Amendamenti 2, dy propozime.

Në rend të parë e votojmë amendamentin e Komisionit Funkcional, variantin a.

Lus regjinë dhe deputetët, votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar, 27 për, 44 kundër dhe një abstenim.

Shkojmë në votimin menjëherë të variantit b, te amendamenti 2, votojmë tash!

71 deputetë, 44 për, 23 kundër dhe 3 abstenime.

Kalon amendamenti 2, varianti b.

Amendamentet 3 e 4, me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Shkojmë drejt në votim për të dytë. Votojmë tash!

72 deputetë, 70 për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

Amendamenti 5.

I ka dy propozime.

Është ai i Komisionit Funkcional dhe deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Albulena Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe këtë çështje e kemi diskutuar vetëm sa për sqarim, të gjitha këto që sot po i diskutojmë, 2-3 herë radhazi dëgjime publike, por edhe në grupe punuese i kemi diskutuar në komision, por natyrisht s'ka pasur pajtueshmëri, prandaj kemi ardhur me dy propozime në seancë.

Më vjen mirë që dy amendamentet e deputetit Korab Sejdiu e morën përkrahjen e deputetëve të Kuvendit. Po i kthehem amendamentit që kam propozuar.

Ministria e Drejtësisë me ndryshimin në Projektligjin për prokurorin e shtetit ka propozuar që të hiqet një nen që rregullon statusin e stafit administrativ përbrenda institucioneve të drejtësisë.

Ligji që është në fuqi parasheh që Ministria e Drejtësisë duhet të nxjerrë një ligj të veçantë që rregullon statusin e zyrtarëve të cilët punojnë në institucione të drejtësisë, rrjedhimisht një ligj për administratën gjyqësore. Në vend që Ministria e Drejtësisë ta nxjerrë atë ligj për administratën gjyqësore, për shkak se është shtylla e sistemit të drejtësisë, ajo bën propozime që i heq komplet nenet, të cilat e rregullojnë statusin e stafit administrativ përbrenda Ligjit për prokurorin e shtetit.

Dhe amendamenti im ka të bëjë vetëm me obligimet e Ministrisë së Drejtësisë në nxjerrjen e një ligji të veçantë që do të rregullonte gjithë stafin në institucione të drejtësisë, qoftë në gjykata, në këtë rast në prokurori.

Prandaj, unë i ftoj deputetët e Kuvendit që të refuzojnë apo të kundërshtojnë propozimin e Komisionit Funkcional, rrjedhimisht atë për legjislacion dhe të përkrahin amendamentin që kam bërë unë. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim.

Amendamenti 5, dy propozime.

Shkojmë në variantin a, me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

68 deputetë, 33 për, 27 kundër dhe 8 abstenime.

Shkojmë në amendamentin 5, varianti b. Votojmë tash, varianti b.

67 deputetë, 31 për, 34 kundër dhe 2 abstenime.

Kalon varianti a, i amendamentit 5.

Amendamenti 6.

Deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Fjalën e ka deputetja.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Është edhe amendamenti 6, që është pa përkrahjen e komisionit, por që është jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm.

Po e lexoj për hir të deputetëve, por edhe të atyre që po na ndjekin.

Amendamenti është ky: “Për kryerjen e përgjegjësive të tyre, çdo prokuror duhet të ketë nga një bashkëpunëtor profesional”.

Ky amendament është jashtëzakonisht i rëndësishëm për faktin se sot prokurorët në Republikën e Kosovës ballafaqohen me shumë probleme, me shumë ngarkesa në mungesë të bashkëpunëtorëve profesionalë, ata detyrohen që vetë t’i bëjnë ftesat për palët në procedurë dhe për çështje komplet administrative dhe teknike. Prandaj, edhe unë kam propozuar që secili prej prokurorëve në Republikën e Kosovës ta ketë të paktën, apo siç është amendamenti, një bashkëpunëtor profesional.

Për gjyqtarë do të duhej të ishin dy bashkëpunëtorë, por meqë jemi duke folur për prokurorë, besoj që në rrethana që jemi dhe për shkak të buxhetit nuk mund ta ngarkojmë me dy, por vetëm me një bashkëpunëtor profesional.

I ftoj deputetët e Kuvendit që ta mbështesin këtë amendament.

KRYETARI: Armend Zemaj, le të bëhet gati Shkëmbin Demaliaj.

ARMEND ZEMAJ: Është komision interesant ky komision i ligjeve, sepse kur të dëgjosh kryetaren e komisionit të mos votohet diçka çka thotë komisioni, dhe e dëgjion nënkryetarin e komisionit të mos votosh diçka tjetër, me të vërtetë është sharmi i demokracisë, siç thoshte një koleg yni i vjetër.

Po ky është i rëndësishëm, me të vërtetë është i rëndësishëm ky amendament dhe ftoj që edhe deputetët e tjerë ta përkrahin, sepse me të vërtetë nevoja për bashkëpunëtorë profesionalë për çdo prokuror në kryerjen e detyrave të tyre është më se e nevojshme.

Tash kapacitetet buxhetore ne të gjithë i dimë, por nëse ka mundësi të ketë reduktim të shpenzimeve diku tjetër, është mirë që të sigurohen bashkëpunëtorë profesionalë. Unë i ftoj edhe deputetët e tjerë që ta përkrahin.

KRYETARI: Faleminderit! Shkumbin Demaliaj e ka fjalën, le të bëhet gati Sami Kurteshi.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Ndoshta para opinionit publik nuk po di të flas me gjeste, me forma për të qenë më bindës, sepse kanë përfituar një shprehje se gjoja po u dhimben qytetarët, e ka një Kushtetutë në dorë, një dokument apo diçka tjetër.

Ky amendament nuk ka kaluar në komision për shkak se nuk ka deklaratë financiare lidhur me shpenzimet për të kaluar amendamenti, kur flasim për punësimet. Ne në komision i kemi pasur dy mekanizmat kryesorë të drejtësisë: edhe Këshillin Prokurorial, edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe i kanë bërë kërkesat e nevojshme buxhetore rreth stafit për vitin 2018, kur ka kaluar buxheti. Edhe kërkesat e tyre në vazhdimësi me rastin e kalimit të buxhetit për vitin 2019 besoj se do të kalojnë kur ato janë të nevojshme. Neve s'kemi pasur deklaratë financiare, Komisioni për Buxhet edhe ai për çështje financiare nuk kanë vlerësuar se sa ka implikime buxhetore ky amendament. Ne nuk jemi kundër punësimit të njerëzve, ne e dimë që ka kapacitete të vogla, ndoshta të administratës në Prokurori, edhe në gjykata, por edhe në të gjitha institucionet, sepse njerëzit kanë nevojë të punësohen, por jo të thirremi në atë se ne po duam të ndihmojmë një mekanizëm, ndërkaq para dy javë ditësh kanë dërguar një kërkesë për ta shqyrtuar një vendim që duhet t'ua ulim rrogat gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ti dëshiron ta ndihmosh një proces, gjoja se po duam ta punësojmë dikë, a vendimet që i merr pushteti i adresojmë duke i kundërshtuar ato. Në këtë kuptim, e kemi kundërshtuar këtë çështje, për shkak se nuk ka një deklaratë financiare. E dimë se ka nevojë për një, po ndoshta edhe dy, sepse ka lëndë që presin me 20 vjet në gjykatat e në prokuroritë tona, por është e nevojshme të ulemi dhe të regjistrohet një deklaratë financiare, e implikimeve buxhetore lidhur me këtë çështje. Ne i kemi përkrahur edhe kërkesat e këtij komisioni që kanë qenë do të thotë me rastin e buxhetimit, kërkesat që kanë ardhur nga këta mekanizma i kemi kaluar edhe me rastin e punësimit, bile janë 136 për këtë vit. Po më vjen interesant, po kalojnë ligjet, do të thotë edhe këto amendamente për shkak të mundësisë së numrave.

Unë mendoj se komisioni i ligjeve nuk është duke e kryer detyrën e vet, nuk është duke e kryer për shkak se praktikën e përditshme po mundohen ta amendantojnë dhe ta fusin në legjislacion. Nuk kemi nevojë për kodekse, kryetar, ne kemi nevojë që në ligj të jepet mundësia, në asnjë ligj deri tash nuk kam parë përfshirjen, që t'i jepet mundësi një mekanizmi ligjor apo një mekanizmi institucional, ose gjatë nxjerrjes së një ligji, që një diçka të rregullohet me akte nënligjore. Po të gjitha ato akte i akumulojmë dhe po mbarojmë kodekse, e amendamentet më shumë janë fjalë, shprehje gjyqësore, se s'po më pëlqen kjo fjalë. Mirë e pati zoti Zemaj më herët që tha se ka kaluar 40%, po thjesht janë shprehje gjyqësore se po përshtatet kjo më shumë dhe vjen në formë amendamenti. Le ta rregullojë Zyra e çështjeve ligjore, edhe në Qeveri, por edhe në Kuvend ata që merren me standardizimin e gjuhës dhe pjesën tjetër teknike, të mos vijnë si amendamente, se dikur kur po flasin për një amendament 15 minuta, po fol një person duke kërkuar edhe replikë.

Kërkoj falje, por kryesorja është s'ka deklaratë financiare lidhur me këtë amendament.

KRYETARI: Faleminderit! A t'u ka përmendur emri? Albulenë, nuk t'u ka përmendur emri, Sami Kurteshi. Albulenë, edhe kështu je e lajmëruar, flet pak më vonë. S'ta ka përmendur emrin, Albulenë. Sami Kurteshi, më vjen keq, Albulenë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ndoshta është me rend edhe replika, por unë do të përpiqem të koncentrohem aty ku është çështja.

Unë dëgjova edhe kolegun nga Komisioni për Legjislacion, kolegun Demaliaj, po ia përmend emrin që të replikojë. Reforma e sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës është ndër reformat më të kërkuara në të gjitha dokumentet ndërkombëtare. Nuk ka deputet të këtij Parlamenti që nuk ka thënë se gjyqësori është keq. Kërkesa që çdo prokuror të ketë një bashkëpunëtor profesional është minimumi çka mund t'i ndihmojmë sistemit gjyqësor. Edhe unë sigurisht do të bëj përpjekje bashkë me kolegët e mi që edhe nga Qeveria ta kërkojmë një fond të veçantë, qoftë edhe prej rezervave për ta ndihmuar sistemin gjyqësor në Republikën e Kosovës.

Bile unë mendoj se nëse çdo prokuror duhet të ketë një bashkëpunëtor profesional, çdo gjykatës duhet të ketë dy bashkëpunëtorë profesionalë. Gjendja në gjyqësorin tonë, edhe mosdhënia e bashkëpunëtorëve profesionalë, duke u arsyetuar se nuk kemi një deklaratë financiare, mendoj se nuk qëndron. Ne duhet të angazhohemi bashkë, të diskutojmë bashkë, por të shkojmë ta kërkojmë një deklaratë financiare nga Qeveria për këtë çështje. Unë mund ta marr me mend se e kemi problem diskutimin në Komisionin për Legjislacion. Vërtet kemi shumë diskutime e kemi shumë përgatitje, unë përsëri e ftoj kolegun Demaliaj të kallëzojë pse nuk po funksionon ai komision. Unë jam aty vazhdimisht, përpiqem aq sa mundem e nuk mund ta marr me mend që zoti Demaliaj ka ndonjë arsye të veçantë të ankohet në punën që e bëjmë ne. Në kualitetin e punës, nuk them në kualitetin tonë profesional, sepse nuk e konsideroj veten shumë profesional, ama ne të bëjmë shumë amendamente në ligje, kjo është puna jonë. Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë tregojmë se kemi shkuar për t'i marr mëditjet. Unë nuk jam për marrjen e mëditjeve, por po kthehem përsëri te kjo.

Unë megjithatë si anëtar i komisionit jam shumë i kënaqur me të gjitha diskutimet aty, me të gjitha votimet, kundërshtimet, humbjet edhe "fitoret" me votime, por unë mendoj se Komisioni për Legjislacion është njëri ndër komisionet që bën një punë të përkushtuar me ligjet.

Tash po kthehem përsëri te amendamenti, domosdoshmëria e sigurimit të njerëzve profesionalë në gjyqësor dhe prokurori nuk vjen ndryshe përveç angazhimit të bashkëpunëtorëve profesionalë që kohë të gjatë punojnë në mënyrë profesionale. Një, duke u ndihmuar prokurorëve dhe

gjyqtarëve dhe, e dyta, duke mbledhur përvojën dhe njëkohësisht duke kryer shkallë të ndryshme të përgatitjes profesionale, arsimimit për përgatitje për gjykatës.

Nuk ka formë tjetër, sidomos në shtetet e zhvilluara, si përgatiten gjykatës dhe prokurorët në një sistem të drejtësisë, në një shtet, nëse nuk fillohet nga bashkëpunëtorët profesionalë. Sepse bashkëpunëtorët profesionalë janë krahu i majtë dhe i djathtë i të gjithë prokurorëve dhe gjykatësve. Prandaj, propozimi për një bashkëpunëtor profesional për prokurorin, unë mendoj se është jashtëzakonisht i qëlluar, mendoj se gjyqtari në Republikën e Kosovës duhet t'i ketë dy bashkëpunëtorë profesionalë, të mos na mbeten nja 400 mijë lëndë të pakryera. Mesatarja e përfundimit të kryerjes së një lënde gjyqësore në Republikën e Kosovës është 8.5 vjet. Ky është problemi që e kemi ne, ne mund t'i ikim këtij problemi, unë jam për atë që me gjithë anëtarët e Komisionit për Legjislacion të ulemi, të diskutojmë e të kërkojmë me ngulm nga kjo Qeveri, këtë punë mund të na e lehtësojë kolegu Demaliaj që ta nxjerrim një deklaratë financiare nga Qeveria, se do të përkrahë futjen ose integrimin e bashkëpunëtorëve profesionalë për prokurorë dhe gjyqtarë.

Kjo është ajo që unë mendoj se është e domosdoshme, edhe është një nga hapat vendimtar për reformën e sistemit gjyqësor, natyrisht duke mos e përjashtuar vetingun e lajmëruar që sa vjet. Faleminderit!

KRYETARI : Edhe shtatë kolegë deputetë janë, a shkojmë në votim, kërkoj mirëkuptim. Po e vëmë në rrezik krejt seancën, po pres, në qoftë se nuk e largoni emrin, unë jua jap fjalën.

Bilalli e Hykmetja janë, për arsye se Shkumbini ka replikë, po ia ka përmendur emrin. Hajdar Beqa është nga komisioni, për fund. A tërhiqeni, zonja Hykmete dhe Bilall, a jo? Nuk tërhiqeni. Zonja Hykmete Bajrami, fjala për ju. Shkumbini, më fal, zonja Hykmete, kërkoj falje, se e ka replikë.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Kryetar!

As që dua ta vë në pah mosprofesionalizmin e komisionit, sikur po mundohen ta trajtojnë para opinionit publik, mirëpo praktika është shumë naive, e them në kuptimin kështu për inate politike. Ne e patëm një ligj më herët, i pati 37 amendamente, binduni se nuk është korrekte opozita në komision. Zoti Kurteshi 37 amendamentet i ka sjellë para komisionit, tani i pasqyron dhe thotë se janë më të mirat, ne ia përkrahim në komision si pozitë. Kryetarja e komisionit vetë që është e opozitës kolegut të vet nga partia e vet që mendon se punon më së shumti ia kundërshton dhe ia voton kundër amendamentet.

Kjo është praktika e keqe, thashë, që po na ndjek, për shkak se ka inate në komision, nuk jam duke e vënë në pah profesionalizmin e askujt, mirëpo po them se deklarata financiare nuk mund të nxirret nga Qeveria tash, është dashur të trajtohet në komisionet parlamentare, kanë qenë të

gatshëm edhe Ministria e Drejtësisë dhe të gjithë mekanizmat për ta rregulluar këtë çështje, jo pse kthehemi mbrapa te sponsorizuesi, në leximin e parë, kur jemi në fund të leximit të dytë. Kërkoj falje, por kjo ishte, nuk po dua të rëndoј askënd, po flas për çështje praktike, si po zhvillohen këto procedura edhe në komision, edhe në Kuvend tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Shkumbin! Kundër-replikë kanë kërkuar Sami Kurteshi dhe Albulena Haxhiu, pastaj ti ke mundësi edhe për një kundër-replikë, në qoftë se dëshiron. Sami Kurteshi, kundër-replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Megjithatë, unë e kuptoj kolegun, po nuk ka inate politike. Unë ia përmenda emrin me qëllim pak më parë të polemizojmë në lidhje me propozimin dhe të më tregojë që ka inate politike pse votojmë ashtu. Nëse thotë se unë i kam sjellë 37 amendamente, unë gëzohem, domethënë se kam punuar, por unë po them që s'i kam sjellë vetë. Ne e kemi pasur një diskutim publik, i kemi pasur tri mbledhje të grupit punues, në asnjërën prej tyre nuk ka qenë kolegu.

Tash, edhe të më caktojnë kryetar të grupit punues, edhe të mos sjell amendamente, kjo i bie të hysh në ujë e të mos lagesh, te ne vetëm ato shotat hyjnë në ujë e nuk lagen, s'ka mundësi tjetër. Nëse më është kërkuar të punoj, ta rregullojmë ligjin, aq sa është e mundur, por jo në këtë ligj, por në ligjet e tjera, atëherë unë po punoj, po e kryej punën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Haxhiu, pastaj zonja Hykmete Bajrami bëhet gati, në qoftë se s'ka kundër-replikë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Këtu u përmendën së pari çështjet buxhetore, thatë që nuk ka deklaratë financiare. Zoti Demaliaj, a mund të më tregosh në cilën rregullore, në cilën pikë kërkohet që amendamentet të kenë mbështetje financiare, askund. Në qoftë se Kuvendi vendos për këtë amendament, pastaj Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, kryeministrin, pra Qeverinë, do të duhej që t'i gjejnë mjetet për zbatimin e ligjit që hyn në fuqi.

Është interesante se po flasim për sistemin e drejtësisë, nuk ka kuptim të flitet për forcim të sistemit të drejtësisë në qoftë se dalim kundër këtij amendamenti. Në secilin takim që kemi pasur si komision, si grupe punuese, me përfaqësuesit e prokurorive dhe gjykatave, çështja e parë, të cilën e kanë ngritur në komision ka qenë nevoja për shtim të bashkëpunëtorëve profesionalë. Janë në kaos të paparë, prandaj ne e kemi obligim që t'u ndihmojmë në këtë drejtim dhe pse asnjëherë s'bëhet problem buxheti kur flitet për pagat e zyrtarëve të lartë. Kur Qeveria Haradinaj ka vendosur t'ia rrisë pagat vetes, pse në atë kohë nuk u bë një vlerësim në aspektin financiar, a

ka buxhet a s'ka, a ka ngarkesë? Po, kur po flitet për çështje tepër të rëndësishme, vihet në pikëpyetje buxheti. Prandaj, unë po them që në qoftë se deputetët e votojnë, e unë uroj që ta votojnë, pastaj Qeveria obligohet që në kohën e rishqyrtimit buxhetor t'i gjejë paratë edhe për zbatimin e këtij ligji.

Unë edhe një herë i ftoj deputetët që ta përkrahin këtë amendament, besoj që është tepër i rëndësishëm dhe nuk merrem me çështje të tjera, të cilat i ngriti zoti Demaliaj. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Demaliaj, kundër-replikë!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Po, kryetar! Është e rëndësishme e gjithë kjo që po bisedohet, unë mendoj se nuk i kemi kaluar kufijtë e procedurave, por dihet se si janë deklaratat financiare, rregulloret. Unë kërkova nga kolegja Hykmete Bajrami, meqenëse është eksperte e fushës dhe e ka kërkuar fjalën pas meje, t'i tregojë se si janë deklaratat financiare. Edhe kërkesat e mëhershme të Qeverisë që i përmende kanë qenë para ardhjes të projektligjit, që është Ligji për buxhet të vitit të kaluar dhe tani, në këtë kohë për të bërë kërkesa për punësim deri të rebalanci i buxhetit jemi shumë shkurt, ka përfaqësues të komisioneve parlamentare, besoj se do të mësohemi ngadalë proceduralisht qysh funksionon Kuvendi dhe mekanizmat institucionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, zonja Hykmete Bajrami, fjala për ju, se u zgjat kjo replikë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Aspak nuk do të zgjatem, janë dy çështje: edhe për amendamente duhet deklaratë financiare, për shkak se arsyeja pse amendamentet shkojnë në Komisionin Funkcional për Buxhet dhe Financa është pikërisht për të parë nëse ato kanë kosto buxhetore ose nuk kanë.

Ju lutem, ju dëgjova më herët! Tjetra është, amendamentin duhet ta përkrahim, zoti kryetar i Kuvendit dhe kolegë deputetë, mos harroni se kur kemi votuar buxhetin e vitit 2018, janë mbi 300 pozita të lira që janë buxhetuar në buxhetin 2018 në sektorin e gjyqësorit dhe prokurorisë. I mbetet prokurorisë që të zgjedhë bashkëpunëtorë profesionalë dhe partive politike që t'i mbajnë duart larg nga prokuroria dhe organet e tjera të drejtësisë dhe të mos dërgojnë militantë partiakë, sepse kështu i kemi të stërngarkuara institucionet e Republikës së Kosovës. E përkrahim amendamentin, sepse mendojmë që pozitën janë të buxhetuara, nuk ka kosto shtesë, gjyqtarëve dhe prokurorëve me të vërtetë u duhen bashkëpunëtorë profesionalë, prapë janë ata që i bëjnë termat e referencës dhe lë të lihen të lirë që të zgjedhin njerëz profesionistë, në mënyrë që gjendja në prokurori dhe në gjyqësi në këtë rast, meqenëse i përfshin të dyja, edhe pse ligji është vetëm për Prokurorinë e Shtetit, të rregullohet, sepse gjendja është me të vërtetë e keqe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

U kam premtuar Samiut dhe Albulenës që do të përfshihem në këtë debat. Kemi pasur debat të gjerë dhe të gjatë rreth kësaj çështje edhe në komision dhe secili i kemi dhënë idetë tona në komision se si t'ua sigurojmë nga një bashkëpunëtor profesional dhe jo a t'ua sigurojmë. Se a kanë nevojë a s'kanë nevojë, nuk ka qenë fare për debat, së paku jo në komision. Pra, të gjithë njëzëri kemi thënë po, prokurorët, gjykatësit kanë nevojë për një bashkëpunëtor profesionist, pa dyshim.

Dhe, këtu po diskutohet tash më shumë se e ka buxhet për këtë apo nuk ka, dhe jo a duhet apo nuk duhet. Unë mendoj që nëse kemi vullnet politik që kjo çështje të zgjidhet në funksion të forcimit të sundimit të rendit dhe ligjit, rrugë dhe mënyra gjenden për t'ua siguruar nga një bashkëpunëtor. A e dini sa njerëz profesionalë, të cilët s'besoj që vetëm unë e di, e dini të gjithë, e dinë edhe njerëzit që nuk janë në këtë sallë, të cilët janë të punësuar në administratë shtetërore dhe i plotësojnë kushtet për t'u transferuar në bashkëpunëtorë profesionistë pa lënë fare keq vendin e punës ku janë aty, se janë të mbingarkuar, të gjithë e dimë këtë. Pra, një nga mënyrat se si do të mund të sigurojmë nga një mbështetës profesionist është edhe kjo.

Rëndësi ka që një herë të kalojë ligji, një herë me ligj ata të kenë të drejtë të kenë nga një bashkëpunëtor profesionist, së paku nga këndvështrimi im, nuk do të thotë që nëse sot e miratojmë, nesër na nevojiten paratë që të jenë aty në dispozicion për t'u rekrutuar dhe për t'u punësuar të gjithë ata bashkëpunëtorë profesionistë të prokurorëve. Ashtu-kështu është një proces prej tre deri në gjashtë muaj, besa nganjëherë me një dështim konkursesh shkon një vit, derisa ata të fillojnë punën, pra një pjesë që do të rekrutoheshin me konkurse publike, një pjesë që do të barteshin me konkurse të brendshme, sepse ka shumë njerëz të zotë, gra dhe burra të administratës shtetërore, të cilët do të mund t'i i plotësonin kushtet për t'u transferuar në prokurori dhe për të qenë bashkëpunëtorë të mirë profesionistë të prokurorëve. Nëse i kombinojmë të gjitha këto mënyra, mendoj që me shumë pak para shtesë në drejtim të prokurorisë dhe gjyqësisë do të mund të zgjidhej kjo çështje në mënyrë të mrekullueshme.

Prandaj, unë kam thënë që do të mbështes këtë propozim dhe do të vazhdoj, siç e kam mbështetur në komision, ta mbështes edhe në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Unë 30 sekonda do të flas, e para, është po të kishte bashkëpunëtorë profesionalë këta njerëz që na e kanë bërë turpin dje, s'kishte ndodhur hiq ajo çka ka ndodhur dje. Dhe, e dyta, e kisha lutur Lëvizjen "Vetëvendosje", edhe kolegen e nderuar, Albulenën, që kur kërkon lobim, për të cilën ne "Nisma" do të votojmë pro, të jetë pak më e matur dhe të mos i

bëjë nervozë këta të tjerët, sepse tani ne jemi duke diskutuar për një ligj të jashtëzakonshëm. Dhe e treta, paratë mund t'i sigurojmë, mund t'i heqim disa prej asfalti dhe t'ua qesim prokurorëve, nuk bëhet nami.

Kështu që ne e mbështesim, kemi para sa të duam, veç të vjedhim më pak.

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa, bëhet gati Muharrem Nitaj dhe Memli Krasniqi në fund.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Vetëm për sqarim të opinionit publik, të gjithë anëtarët në komision, e thanë edhe kolegët, kemi qenë pro rritjes së numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë, por ajo të bëhet me procedurë të drejtë, jo të bëhet me propozime populiste të individëve të caktuar, siç e ka bërë zonja Haxhiu.

Ky amendament edhe teknikisht nuk është i përpiluar mirë, nuk e tregon ku duhet të sistemohet në ligj, ne duhet ta kemi edhe një parasysh, se prokuroria, në këtë rast, Këshilli Prokurorial i Republikës së Kosovës të gjitha kërkesat që i ka pasur për punësim edhe Këshilli Gjyqësor iu kanë aprovuar nga Ministria e Drejtësisë, edhe Këshilli Prokuror edhe Këshilli Gjyqësor, edhe Ministria e Drejtësisë janë në fushëveprimtari të komisionit, ne e kemi menduar që duhet t'i thërrasim në komision, të bisedojmë me ta, ta gjejmë rrugën së pari, të shikojmë a i kanë implementuar ato vende të lira, të cilat momentalisht i kanë të aprovuara nga Ministria e Drejtësisë, janë rreth 400 vende të lira, e para. E dyta, ne nuk e dimë a u duhen nga një apo nga dy, ka mundësi diku ndonjë prokurori i nevojiten dy bashkëpunëtorë, dikujt i duhet një bashkëpunëtor. Kjo do të jetë ekuivalencë edhe me gjykatat, sipas vëllimit të punëve. Ne të gjithë kemi thënë do ta përkrahim, por ne e dimë që edhe nëse kalon ky ligj, në këtë rast nuk mund të implementohet deri në vitin 2019. Andaj, unë kisha propozuar që ky amendament kësaj here të mos kalojë, në rishikim të buxhetit dhe në buxhetin e ri që do të bëhet për vitin 2019 ne të bisedojmë si komision në mënyrën më profesionale të mundshëm, t'i marrim kërkesat edhe të Këshillit Gjyqësor, edhe të Këshillit Prokurorial, se për dy ligje duhet të punojmë në këtë drejtim dhe të përkrahim kërkesën e tyre sipas nevojave të tyre.

Ministria e Drejtësisë i ka propozuar dhe disa projektligje të tjera, besoj që komisioni duhet ta dijë apo duhet të jetë i qartë për seancën këtu, në kuadër të të cilëve janë Projektligji për Këshillin Gjyqësor dhe ai për Këshillin Prokurorial, ku kjo çështje e bashkëpunëtorëve profesionalë është e rregulluar në ato dy ligje të tjera, ne nuk është mirë në këtë rast sponsoruesit të bëjmë diçka e të na shohin që ne po jemi për vende të reja të punës, e veç ta komplikojmë një ligj. Derisa sponsoruesi i ka iniciuar dy ligje të tjera, i ka paraparë me këto dy ligje, unë konsideroj që ky nen nuk e ka vendin këtu, edhe pse ne të gjithë jemi këtu në Parlament për ta rritur numrin e bashkëpunëtorëve, sipas kërkesave të tyre. Sipas propozimit të ministrisë, çështja e bashkëpunëtorëve profesionalë, statusi i tyre, përgjegjësitë, si dhe kriteret do të rregullohen me

akte nënligjore, ashtu ka thënë edhe Këshilli në komision, edhe Këshilli Gjyqësor, edhe Këshilli Prokurorial, por edhe Ministria e Drejtësisë.

Andaj, realisht në parim jemi për ta rritur numrin e bashkëpunëtorëve sipas nevojës, nëse janë nevojat dy, dy. Nëse janë nevojat tre, tre. Nëse është nevoja një, një, por jo në këtë formë pa e ditur ende, pa pasur raport. Ne kemi mundur të jemi më profesional e ta thërrisnim këshillin, ta thërrisnim Prokurorinë, të shihnim sa i kanë kryer ato që i kemi aprovuar ne në këtë Kuvend me Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Unë mendoj që ky amendament nuk e ka vendin tashti këtu, po ta marrim si obligim Parlamenti, ta marrim si obligim deputetët që ta përkrahim Këshillin Prokurorial, ta përkrahim Këshillin gjyqësor, që të paktën nga 1 janari i vitit 2019 me të vërtet të kenë staf të duhur. Faleminderit!

KRYETARI: Muharrem Nitaj e ka fjalën. Po më vjen mirë që Lëvizja “Vetëvendosje” ka reagim nervoz për shkak të diskutimeve. Më vjen mirë!

MUHARREM NITAJ: Zoti kryetar!

I kam vetëm 15 sekonda. E kam një pyetje për ju: A ka farë mekanizmi që brenda një seance të mos i jepet fjala të njëjtëve deputetë, që diskutojnë nga 5 herë për të njëjtën çështje, me të njëjtat argumente? Është ditë e premte, kam përshtypjen që po sillemi si njerëz që nuk e kemi një cak. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka mundësi, por zakonisht replikë - kundër-replikë, sa herë i përmendet emri, s'ke qare pa ua jep. Kjo është ajo pjesa në të cilën jam i detyruar, por më mirë të konsumohet debati deri në fund, se sa të kemi reagime, se ligjet po shkojnë shpejt, aq më tepër këto ligje të gjitha ndërliken me agjendën e reformave evropiane, kine parasysh.

Faleminderit! Po më pëlqen pragmatizmi shumë. Atëherë, a shkojmë drejt në votim? A dëshironi me shkua drejt në votim? Jo. Atëherë, Sala Berisha-Shala. Bëhet gati Nezir Çoçaj.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Kryetar, unë desha të kërkoj prej administratës që e mbështet udhëheqësin e seancës t'i tregojë se në lexim të dytë nuk ka debat. Ju lutem! Debatet zhvillohen në lexim të parë të projektligjeve edhe shteren debatet në komision. Ndërkohë, që gjatë leximit të dytë ka të drejtë ta marrë fjalën vetëm ai që ka bërë amendament dhe eventualisht kryetari i komisionit. Mos të zhvillojmë tani debat, secili kemi për të thënë diçka. Ne e kemi ndarë mendjen nëpër grupe parlamentare çka me votua e qysh me votua, kështu që mos të humbim kohë më shumë. Kjo është kërkesa ime.

E dyta, kur të hedhet amendamenti në votim, nëse e merr shumicën e deputetëve prezentë nuk ka nevojë të votohet edhe një herë tjetër për amendamentin tjetër. Ta shkurtrojmë kohën, sepse nuk

po e shoh shumë të arsyeshme. Po më duket debat koti. Edhe me këto debate që po i zhvillojmë nuk mund t'ia mbushim mendjen njëri-tjetrit, ne tashmë jemi përcaktuar se si të votojmë. Kaq.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Por, kisha pasur dëshirë, lodhuni nga pak lexoni, më mirë është, ju bën hair, ka nevojë nganjëherë të mësohet, unë valla më së qejfi kam kur më mësoni. Merreni lexojeni Rregulloren. Salë, ke mund të thuash edhe në Grup Parlamentar, po tash mbasi po e them në këtë mënyrë, po shkoj edhe unë me sarkazëm. Neni 58, pika e parë te shqyrtimi i dytë e tani në seancën tjetër na tregon a kam të drejtë unë, a ti. Neni 58, pika e parë u jep të drejtë deputetëve dhe unë s'kam të drejtë në mënyrë arbitrare t'ia ndalë fjalën askujt. Unë kërkoj mirëkuptim prej juve, po ju jeni tanë mësuesit e mi, keni për të fituar vota shumë në këtë formë, thjesht. Po, koncentrohuni te materia.

Hajde a shkojmë, sa të lajmërohen. Qe edhe Arbeni si interpretues i Rregullores. Nezir Çoçaj. Arben, a e ke marrë fjalën, mos ta bëjmë dy herë. Këtë herë jo? Eh, po atëherë Arbeni pastaj, Nezir Çoçaj njëherë.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Do të flas shkurt. Unë jam shumë i sigurt, se bashkëpunëtorët profesionalë janë shumë të domosdoshëm dhe të nevojshëm, por në të njëjtën kohë kisha kërkuar që edhe pasi jam pjesë e Komisionit të Arsimit të kërkoj edhe nga Komisioni i Arsimit, gjegjësisht nga kryetari i komisionit, që ta shtrojë nevojën e bashkëpunëtorëve profesionalë në shkolla e sidomos në ato paralele që kanë fëmijë me nevoja të veçanta. Është më se e domosdoshme, që këto shkolla e sidomos këto paralele, t'i kenë këta bashkëpunëtorë profesionalë.

Të gjithë kemi diskutuar se në çfarë shtate dhe në çfarë rrethanash vepron sistemi i arsimit në Kosovë. Mendoj se jo vetëm shkollat dhe sistemi i drejtësisë, po edhe deputetët kanë nevojë për bashkëpunëtorë profesionalë po edhe shumë sektorë në Kosovë kanë nevojë për bashkëpunëtorë profesionalë. Veç, e kemi problemin e mjeteve financiare. Faleminderit!

KRYETARI: Arben, fjala është për ty. A ta përmendi emrin, Albulenë? Jo, jo, drejt, bëhu e sinqertë. A ta ka përmendur emrin? S'ka kuptim. Edhe parëz u mërzipte duke folur këta, tash ta lëmë ta përfundojë. Hajt, se po shkojmë drejt përfundimit. Arben, e ke fjalën. Kush ka folur nuk ia jap, vetëm në qoftë se ua përmendi emrin, mos më keqkuptoni.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Veç sa për sqarim. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës të drejtën për secilën pikë të rendit të ditës e ka secili deputet dhe nuk mundet dikush në mënyrë arbitrare të gjykojë nëse diskutimi i një deputeti është i vlefshëm a i pavlefshëm apo të japë vlerësime tjera. Nuk ka asnjë lloj mundësie që dikush t'ia ndërpresë të drejtën e fjalës, të drejtën e diskutimit dhe të drejtën e

votimit asnjë deputeti. Prandaj, mendoj se duhet të jemi më korrektë edhe me kolegët dhe me mënyrën sesi i trajtojmë.

Rregullorja e punës së Kuvendit, po ashtu përcakton kush ka të drejtë replike, kush ka të drejtë kundër replike dhe po ashtu në Rregullore të punës së Kuvendit përcaktohet se kur mund të ndërpritet debati dhe mënyra se si ndërkrehet debati. Mos bëni kesi lloj deklarimesh dhe veprimesh, sepse është e pandershme për kolegët e juaj dhe është jo konform Rregullores. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi, je para publikut, në qoftë se ta kanë përmendur, por në qoftë se s'ta kanë përmendur mos e merr fjalën, se skuqesh fort. A ta kanë përmendur emrin? Unë të besoj ty. Ismajl Kurteshi, në qoftë se ta kanë përmendur emrin, veç ngrite dorën merre fjalën, që s'ta kanë përmendur... Merre, fjala për ty është, replikë.

ISMAJL KURTESHI: Nezir Çoçaj ka kërkuar deklarin e kryetarit të Komisionit për Arsim dhe në këtë kuptim ma ka përmendur emrin dhe e mora fjalën vetëm për ta përkrahur atë që e propozoi deputeti Çoçaj. Kjo ka qenë edhe amendament i Arbërie Nagavcit. Atëherë është refuzuar, por tash është mirë që një gjë e tillë të kalojë, sepse vërtet është një kërkesë shumë e drejtë që fëmijët me nevoja të veçanta të kenë asistentë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar!

Edhe unë besoj që ndoshta të gjitha grupet parlamentare do të kemi mirëkuptim që të mundohemi të jemi më ekspeditivë në trajtimin e gjithë këtyre projektligjeve, meqenëse jemi pajtuar ashtu edhe në seancën e kaluar dhe kam frikën, se me shkuarjen e deputetëve një nga një, ose dy nga dy, do të mbetemi përsëri pa kuorum. Jemi pajtuar që e kemi afatin e fundit për këto ligje deri më 31 mars dhe është dita e fundit sot që mund t'i kalojmë.

Po, për t'iu kthyer çështjes së amendamentit, mendoj se duhet ta kemi një gjë të qartë të gjithë. Nuk rregullohet çështja e papunësisë me këtë amendament, sepse u tha "punësimi - shpunësimi...". E para është kjo.

E dyta, të gjithë jemi në favor të shtimit të kapaciteteve në prokuroritë e Kosovës, sepse jemi të gjithë të vetëdijshëm se është një volum jashtëzakonisht i madh i punëve dhe i vonesave tradicionalisht që kanë ndodhur atje. Tjetra që dua të them, është që kjo realisht është kompetencë aktuale e Këshillit Prokurorial dhe Këshilli Prokurorial ka të drejtë me vendos për punësimin apo për caktimin një bashkëpunëtori profesional, po pse jo dy bashkëpunëtorëve profesionalë, dikujt edhe tre, ose pesë, bashkëpunëtorëve profesionalë, nëse është e nevojshme në prokurori të caktuara dhe varësisht nga volumi apo edhe serioziteti i lëndëve të cilat ata i

trajtojnë. Në këtë drejtim amendamenti siç është propozuar nga deputetja Albulena Haxhiu, unë mendoj se sikur të përfshihej në ligj na e shkakton një problem, se ua pamundëson prokurorëve në të ardhmen që t'i kenë dy bashkëpunëtorë profesionalë, sepse nëse ne në ligj themi që për kryerjen e përgjegjësive të tyre çdo prokuror duhet ta ketë nga një, atëherë nesër ne pa e ndërruar ligjin s'mund t'ua lejojmë atyre që t'i kenë nga dy apo tre.

Unë mendoj që ne duhet ndoshta t'ua mundësojmë të kenë edhe më shumë se sa një. Kështu që si grup parlamentar ne thashë në frymën e këtij amendamenti jemi në përkrahje dhe kemi qenë edhe më herët, përkundër që realisht amendamenti nuk është specifikuar ku duhet të vendoset, ndoshta edhe këtë gjë është dashur ta bëjë deputetja, të thotë se është neni kaq, zëvendësohet ky ose ai, ta gjejë vendin saktë në projektligj. Por, ne do ta votojmë këtë amendament, nëse pajtohen deputetët dhe propozuesja, para së gjithash, që t'i shtohet propozimit të saj togfjalëshi "së paku". Pra, unë propozoj që amendamenti të votohet si në vijim: "Për kryerjen e përgjegjësive të tyre çdo prokuror duhet të ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional." Kjo pastaj lë hapësirë Këshillit Prokurorial konform kompetencave të tyre, që bazuar edhe në këtë ligj të vendosë së paku një, po pse jo edhe dy apo edhe më shumë.

Ndërsa, për vendet e punës për financat, është e vërtetë që duhet të ketë një kosto, duhet të ketë një vlerësim, por ajo që është e rëndësishme kemi parë që Qeveria, para së gjithash ministri i Drejtësisë, i ka dhënë mbështetjen e plotë, e ka rritur buxhetin për të gjitha instancat në institucionet e Drejtësisë, edhe për shtimin e vendeve të punës dhe besoj se edhe ministri i Drejtësisë, i Financave dhe Qeveria në përgjithësi, do të kenë mirëkuptim që nëse jo përmes rishikimit, së paku ta krijojnë këtë mundësi përmes buxhetit të vitit të ardhshëm e tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, gjithsesi e ke marrë edhe një këshillë nga Administrata. Për çdo rast, ta përfundojmë një herë, se në fund do ta merrni ju gjithsesi fjalën. Dardan Sejdiu. Nuk ka asnjë deputet më, pastaj është edhe propozuesja, e cila... se ka edhe disa probleme të cilat kanë të bëjnë me vet formulimin si amendament. Urdhëro!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Meqë u diskutua kaq gjatë po dua vetëm të them, se sot e kemi një amendament këtu që e ka sjellë deputetja Albulena Haxhiu, e kemi dikë nga komisioni i cili e ka argumentuar pse nuk duhet deputetja Haxhiu, pse duhet kjo... dhe i kaluam diku afro 30 minuta jo rreth nevojës për të futur këtë amendament, sepse është e domosdoshme që prokurorët të kenë bashkëpunëtorë profesionalë, po rreth temave që janë komplet periferike e nuk ndërlidhen fare me amendamentin e propozuar.

Kisha kërkuar meqë jemi në afate të fundit kohore për t'i përmbushur obligimet që lidhen me reformat që ndërlidhen me integritet evropiane, që të mos humbim shumë kohë në këto tema.

Dhe, në anën tjetër, deputeti Memli Krasniqi e dha një propozim e unë po mundohem ta jap edhe unë një propozim, pasi që veç po japim propozime, pra do të propozoja që ky amendament, po pikërisht, gjithkush po jep propozim. A kam të drejtë, a s... Po, mirë de!

Pra, po them që amendamenti duhet të jetë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Çdo prokuror duhet të ketë bashkëpunëtor profesional, pra mos të jetë “së paku një” apo “një”, po thjesht “bashkëpunëtor profesional”.

KRYETARI: Faleminderit! Tani janë edhe këto vërejtje, propozime, në të njëjtën kohë edhe një këshillë juridike nga Administrata e Kuvendit. Propozuesja Albulena Haxhiu jep propozimin e vet, pastaj shkojmë në votim. Fjala për ju.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Tash problemi nuk qëndron te deputetët që bëjnë amendamente, por problemi qëndron tek ministrinë që bëjnë propozime në plotësim ndryshime të plotësim ndryshimit. Prandaj, shpesh kemi probleme në referenca dhe të tjera si këto.

Unë e kam propozuar këtë amendament. Dje, për një votë nuk ka kaluar në komision, fatkeqësisht për shkak se natyrisht do të ishte më fuqishëm sikur të vinte me mbështetjen e komisionit. Kam kërkuar nga Administrata meqë jemi dakorduar, që t’i referohemi ligjit bazik, të jetë edhe ky amendament në përputhje me ligjin bazik, varësisht te nenet përkatëse në ligjin bazik. Kështu ka qenë dakordanca në komision.

Dhe, në fund, unë jam dakord me propozimin e zotit Krasniqi, që thotë “për kryerjen e përgjegjësive të tyre çdo prokuror duhet ta ketë”, që të shtohet “së paku nga një bashkëpunëtor profesional”.

Tash, rrethanat janë kështoj që do të duhej ta kishin të paktën nga një bashkëpunëtor, në të ardhmen mund të rritet buxheti, mund të shtohen nevojat dhe mund të kenë dy-tre apo katër bashkëpunëtorë profesionalë. Pra, jam dakord që fjala “së paku” t’i shtohet këtij amendamenti. Faleminderit!

KRYETARI: Me këtë propozim, ju lutem, të përgatitemi për votim. Regjia dhe deputetët, votojmë!

Amendamenti 6, deputetja Albulena Haxhiu propozimin e fundit të cilin e dha, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar. 55 janë për, 6 kundër, 3 abstenime.

E falënderoj Xhelën për asistencën e tij. Kalon ky amendament.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. E kemi një deputet pa kartelë, zonjën nënkryetare, Myfera. Votojmë tash!

65 deputetë, me nënkryetaren 66, 65 deputetë për, 64 elektronike një me dorë edhe 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e komisionit, zotërinë Driton Selmanaj që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në pajtim me Rregulloren e Kuvendit në disa mbledhje të mbajtura ka shqyrtuar Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018 ka aprovuar raportin përfundimtar për këtë projektligj.

Gjatë punës në shqyrtim të këtij projektligji Komisioni ka arritur të përgatisë 15 amendamente, të cilat janë të paraqitura në raportin përfundimtar. Të gjitha arsyetimet për secilin amendament i keni në raportin përfundimtar të këtij projektligji. Andaj, bazuar në këtë i ftoj deputetët të votojnë këtë projektligj me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 15 amendamente. Të gjitha janë të përkrahura nga Komisioni Funkcional. Po i votojmë të gjitha përnjëherë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Nga 1 - 15 amendamente. Votojmë tash! Zonja Myfera voton me dorë.

62 deputetë kanë votuar, 61 në mënyrë elektronike, një me dorë. 61 deputet, përkatësisht 62 edhe një me dorë janë për. Kalojnë të gjitha amendamentet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Të nderuar kolegë deputetë, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar. Zoti Fikrim, më lejo të konstatoj, ju nuk e keni prekur apartat... në rregull. 62 deputetë kanë votuar, 61 me elektronikë e 1 me dorë. 62 deputetë kanë votuar për, të gjithë.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike.

I ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që të ftojnë kolegët deputetë që janë ende në hapësirën e Kuvendit, për arsye se jemi në proces të votimit.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-026 për azil

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë e ka trajtuar dhe shqyrtuar këtë projektligj në mbledhjen e fundit më 29. 3. 2018, dhe i rekomandon Kuvendit që ta aprovojë këtë projektligj me 31 amendamente të propozuara nga Komisioni Funkcional. Shumica janë të natyrës teknike dhe përmirësime të gabimeve gjuhësore, andaj lus deputetët që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 31 amendamente. Zoti Kurteshi, e dëshironi fjalën apo...

E ka kërkuar fjalën. Jemi para votimit. Vetëm zotëri Kurteshi, urdhëroni!

SAMI KURTESHI: A keni... nëse dikush ka një problem, që një koleg po e merr fjalën, tregoni dhe unë e lëshoj seancën. S'kam problem!

KRYETARI: Jo, jo, jo, vetëm ta kini parasysh. Rregullorja do të respektohet në përpikëri, i pëlqeu dikujt a s'i pëlqeu. Fjala s'do t'i ndalet askujt, për aq sa kam të drejtë.

SAMI KURTESHI: Unë e di që janë lodhur, sepse edhe unë jam këtu duke ndenj tërë ditën me ta. Edhe pak jemi mërzitur, na janë mbledhur shumë ligje... po, unë mendoj se duhet pasur mirëkuptim për disa ligje, për të cilat dikush ka interesim e dikush s'ka. Po, unë kam interesim për Ligjin për azil dhe për Ligjin për të huajt dhe pikërisht interesimi im që është edhe me natyrë emfatike dhe me natyrë profesionale, ka të bëjë me ngjarjet e djeshme dhe të sotme me qytetarët e Republikës së Turqisë, që janë marrë në Republikën e Kosovës, as nuk dihet si, as çka ka ngjarë, as çka do të ngjet me ta.

Para dy muajsh, kur është trajtuar ky ligj, ne i kemi tërhequr vërejtjet tona. Unë i kam bërë vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet, disa prej tyre janë futur. Unë mendoj se ne si shoqëri dhe si Kuvend duhet të kemi kujdes të shtuar dhe të jashtëzakonshëm, sa u përket këtyre dy ligjeve që tash do të vijnë këtu për votim, është Ligji për azilin dhe Ligji për të huajt. Para dy muajsh janë tërhequr në parim dy-tri vërejtje. Vërejtja e parë ka qenë që të bëhet përpjekje që njerëzve të ndjekur të mos u shtohet dhembja, sepse asnjë njeri në Botë nuk ikë nga vendlindja për shkak të dëshirës. Ligji për azil e prek pikërisht këtë dhembje të njerëzve që ikin nga vendlindja e tyre.

Duhet të kemi kujdes të shtuar ndaj atyre njerëzve. Natyrisht, përgjithësimi është në kuptimin pozitiv, pa i marrë rastet veç e veç, sepse gjithkund në botë me të ikurit shkojnë edhe kriminelët. Kjo është një çështje.

Çështja e këtij ligji ka të bëjë domethënë që të prekë edhe në aspektin profesional, edhe në aspektin praktik, edhe emfatik shumicën e shqiptarëve të Republikës së Kosovës. Unë nuk mendoj që ka në çdo të dytin banorë të Republikës së Kosovës që nuk e ka përjetuar një herë, ata që janë mbi moshën 18-vjeçare, që nuk e ka përjetua njëherë ikjen pa dëshirën e tyre nga vendlindja, dhe kjo është ajo që unë po kërkoj ta kemi parasysh të gjithë ne.

Çështja tjetër është, neve na ka ngjarë një deportim i shtetasve të huaj dhe ky deportim ka ngjarë para syve tanë.

KRYETARI: Ju kisha lutur, ju lutem ta kryejë deputeti! Urdhëro zoti Kurteshi, të lutem, vazhdo!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!
E respektoj zhurmën që e bëjnë.

Ne e kemi një problem shumë të madh, sepse e kemi një terr informativ institucional mbi atë çfarë dje ka ngjarë. Edhe nuk po duam të merremi seriozisht me te. Kjo është ajo çka mua po më shqetëson më së shumti.

Unë edhe paradite kam dashur të kërkoj, por edhe tash po kërkoj, meqenëse nga gjithë kolegët deputetë, pa marrë parasysh përkatësinë, po e shfrytëzoj kohën time në Ligjin për azilin dhe për të huajt që të hiqet çdo lloj diskriminimi ndaj njerëzve të huaj dhe ndaj njerëzve që kërkojnë strehim në vendin tonë, qoftë përkohësisht, apo për kohë të gjatë, që prek dinjitetin e njeriut në çfarëdo forme.

Ne nuk e kemi në Kushtetutën tonë, mirëpo me kushtetutat tjera të botës shteti obligohet që me të gjitha mjetet dhe format ta mbrojë dinjitetin e njeriut.

Po e shfrytëzoj këtë kohë që t'i ftoj të gjithë kolegët e mi dhe koleget e mia deputete, meqenëse ekziston një terr informativ në lidhje me atë çfarë ka ngjarë dje me shtetasit e Turqisë nga forcat e sigurisë, cilado qofshin, në Republikën e Kosovës, ta krijojnë një Komision ad hoc Parlamentar që merret me hetimin e gjithë ngjarjes që ka ngjarë dje në Republikën e Kosovës me gjashtë shtetas turq.

Vetëm një po e them, Republika e Kosovës e ka obligim respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çdo vendim i çdo organi në Republikën e Kosovës që prek të drejtat dhe liritë e njeriut është i obligueshëm të interpretohet me nenin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës sipas vendimeve dhe interpretimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Tash, dhe po e përfundoj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në njërin nga vendimet e Kolegjit të Madh ka vendosur që asnjë njeri nuk mund të kthehet në vendin e origjinës nëse i rrezikohet ose ka rrezik të ushtrimit të torturës edhe të veprimeve çnjerëzore ndaj tij. Ne kemi një kohë që kjo nuk respektohet.

Prandaj, edhe një herë po kërkoj nga të gjithë deputetët kolegë dhe kolege, të ndërmarrin iniciativën, ta krijojnë një Komision Hetimor ad hoc Parlamentar që do të merret me këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Po shkojmë në procesin e votimit.

Janë 31 amendamente.

Do t'i propozoj të gjitha bashkërisht, në qoftë se ju pajtoheni.

Ju kisha lutur, kolegë deputetë që janë brenda sallës i kemi nja 5-6, më tha Administrata, mirë është të vijnë e të votojnë për vetë faktin se ne do të bëjmë edhe publikimin çdo tre muaj të performansës dhe deputetëve, pjesëmarrjes së tyre dhe është humbje kohe e tyre në qoftë se qëndrojnë në sallë e nuk vijnë të votojnë se do të dalin pasqyrat e efikasitetit të deputetëve.

31 amendamente janë, i votojmë të gjitha bashkërisht.

Aktualisht në sallë janë 63 deputetë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

63 deputetë janë në sallë, 63 për. Kaluan të gjitha amendamentet.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

63 deputetë, 63 vota për.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-026 për azil.

5. Shqyrtimi i dytë i projektligjit numër 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-219 për të huajt

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë miratuar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj deputetin Fatmir Xhelili që në emër të Komisionit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë si Komision Funkcional dhe raportues, në mbledhjen e mbajtur, më 29. 3. 2018, e ka shqyrtuar Projektligjin numër 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-219 për të huajt dhe ia rekomandon Kuvendit që ta votojë këtë projektligj bashkë me amendamentet e propozuara, që t'janë 11 amendamente me përkrahje të Komisionit Funkcional.

Sa i përket diskutuesit të mëparshëm rreth Ligjit të azilit, edhe zoti Kurteshi e ka pasur mundësinë për të ardhur dhe propozuar ndonjë amendament, të cilin do ta kishte konsiderua që do ta kishte plotësuar kualitetin e ligjeve në fjalë.

Mirëpo ne u jemi përmbajtur të gjitha direktivave të Bashkimit Evropian dhe të Komisionit për Siguri për ta bërë ligjin sa më funksional dhe me standarde ndërkombëtare dhe është ligj i cili do ta ngrejë cilësinë për kujdesin ndaj qëndrimit të të huajve në vendin tonë, si dhe atyre që kërkojnë azil.

Andaj, unë nuk besoj që ky deputet ka vërejtje në ligjin në fjalë, mirëpo pati nevojë për komente politike, sigurisht në situatën aktuale.

I lus deputetët që të bëjnë votimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, emri të është përmendur, e ke kërkuar fjalën. Urdhëro!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk e kam që m'u përmend emri, po me gjasë edhe kolegu e di që herën e kaluar ne kemi diskutuar në aspektin profesional dhe nuk e di pse është tash diskutim politik.

Unë jam qenie politike, për veprime politike kam ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nuk kam ardhur për çështje tjera.

Mirëpo, nga aspekti ideologjik, filozofik e politik, unë e bëj punën time profesionale dhe ne kemi bërë propozime, propozimet janë integruar në tekst, unë nuk e di pse diskutimi im qenka politik ose jopolitik.

Ne kemi kërkuar që të futen disa ndryshime në këtë ligj. Janë futur dhe nuk po e shoh cili qenka kundërshtimi apo jo kundërshtimi. Nuk po shoh ndonjë mospajtim, qoftë politik apo ligjor profesional në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Xhelili, kundër-replikë, por të ecim në votime.

FATMIR XHELILI: Jo, jo, është e vërtetë, po ne kemi pritur që humanizmin e vet dhe solidaritetin e vet të vijë e ta tregojë me ndonjë propozim në Komision, por ne nuk kemi pasur propozime prej zotit Kurteshi, për atë e pata fjalën, se nuk e pata fjalën që zoti Kurteshi nuk ka të drejtë të diskutojë në drejtimin politik. Ke qenë i mirëseardhur, mirëpo sigurisht vjen tjetër herë dhe i plotëson ato.

KRYETARI: Faleminderit!

11 amendamente, i votojmë të gjitha përnjëherë, nga 1 deri në 11.
Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

62 deputetë kanë votuar, 55 për, 5 kundër dhe 2 abstenime.

Miratohen amendamentet e propozuara.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Janë 61 deputetë, 60 në mënyrë elektronike, një me dorë. Po, 57, 56 në mënyrë elektronike dhe një me dorë, 2 kundër dhe 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-219 për të huajt.

Kisha kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare që të thërrasin deputetët të cilët mund të jenë në sallë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj deputetin Driton Çausi, që në emër të Komisionit për Bujqësi ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

DRITON ÇAUSHI: faleminderit!

Deputetë të pranishëm,

Të bazë të nenin 57 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur, më 27. 3. 2018, e shqyrtoi Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore dhe vendosi t'i paraqesë seancës për votim këtë rekomandim dhe 18 amendamente të përkrahura nga Komisioni FunkSIONAL.

Gjithashtu në Komision kanë ardhur 5 amendamente nga deputetja Teuta Haxhiu, por të cilat nuk e kanë marrë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

I ftoj deputetët që ta votojnë këtë raport.

KRYETARI: Faleminderit!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 23 amendamente. Nga Komisioni FunkSIONAL 18 amendamente, deputetja Teuta Haxhiu e vetme 5 amendamente dhe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zonja Haxhiu, unë tash do t'i radhis vetëm amendamentet të cilat janë të Komisionit FunkSIONAL, pastaj për këto pesë deklaroheni ju si doni t'i votojmë.

Do të thotë 1, 2, 3 i hedh në votim, 5, 6, 7 e hedh në votim, 9 e hedh në votim, amendamentet 12, 13 i hedh në votim, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 61 deputetë, 60 në mënyrë elektronike një me dorë. 61 janë për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Tash do të shkojmë tek amendamentet, zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën për pesë amendamentet e propozuara dhe mënyrën e votimit. Urdhëro, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj mirëkuptimin e deputetëve, ngase unë e kam edhe procesverbalin e Komisionit, është e saktë ajo që u tha që kanë ardhur me shkrim, por në fakt në procesverbal domethënë theksohet decidivisht “për shkak të mospasjes kohë për t’i shqyrtuar amendamentet”.

Prandaj, unë kërkoj mirëkuptimin e gjithë deputetëve që veç e veç, ngase amendamentet e mia janë vërtet të propozuara, por në konsultim me ekspertët e fushës, dhe përkundrazi janë në harmoni me qëllimin e ligjit, e po mundohemi të mos marr kohë shumë, por secilin amendament kërkoj mirëkuptim, ngase po them edhe një herë në procesverbal thuhet “për shkak të mospasjes kohë për t’i shqyrtuar amendamentet”.

KRYETARI: Në emër të Komisionit për Bujqësi, Driton Çausi e ka kërkuar fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Nuk do ta interpretoj procesverbalin, megjithatë ka qenë një rekomandim nga përfaqësuesit e Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore që këto amendamente nuk e përbëjnë ndonjë ndryshim substancial, prandaj edhe nuk e ka gjetur përkrahjen nga Komisioni Funkcional.

KRYETARI: Atëherë, zonja Haxhiu, ju dëshironi një për një të shkojmë. Ne në këtë moment e presim mirëkuptimin e ndonjë deputeti, a po vjen a jo, 60 deputetë jemi. Unë mund të procedoj formalisht, por nuk ka vota. Kryetarët e grupeve parlamentare duhet ta shikoni a keni ndonjë deputet në sallë, apo duhet të takohemi nesër.

Rregullorja është mirë ta përcaktojë përgjegjësinë, zoti Kurteshi është duke u rikthyer, 61 deputetë jemi. Faleminderit, zoti Kurteshi, publikisht.

Atëherë, përgatitemi për votim. Zonja Haxhiu, unë e përmendi secilin, shkojmë një nga një në votim.

Amendamenti katër, deputetja Teuta Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tash! Më fal, ka reagim, tërhiqet, administrata, ju lutem. Urdhëro, dëshironi të shpreheni në çdo amendament. Kërkoj falje, zonja Haxhiu, keni të drejtën tuaj. Urdhëro, zonja Haxhiu, për amendamentin katër.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po pikërisht për arsye se thashë në procesverbal nga komisioni kështu shkruan, atëherë unë kërkoj mirëkuptimin e deputetëve se duhet të më dëgjojnë në secilin amendament dhe pres vërtet mirëkuptim.

Te neni 3, është propozimi i parë ose amendamenti i parë, shërbimi teknik nënkupton një organizatë, e cila ka burime teknike dhe njerëzore, njohuri, trajnim dhe përvojë për të vepruar ose për të dhënë këshilla të mbrojtjes nga rrezatimi sipas këtij ligji. Rekomandimi im është: Institucioni Shëndetësor Publik i nivelit terciar nga fushëveprimtaria e Mjekësisë së Punës, e cila ka burimet teknike dhe njerëzore, njohuri, trajnim dhe përvojë për të vepruar ose për të dhënë këshilla të mbrojtjes nga rrezatimi sipas këtij ligji dhe kompetenca e secilës në këtë aspekt njihet nga agjencia.

Prandaj, vërtet nuk e prek qëllimin dhe as përmbajtjen, por përkundrazi, e pasuron, kërkoj mirëkuptimin e deputetëve për votim.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi prapë në të njëjtën situatë, unë do ta falënderoj çdo Sami Kurtesh që futet në sallë e të bëhen 61 deputetë, jemi në pritje.

A po i lexon edhe katër të tjerat, të lutem? Atëherë, amendamentet 8, 10, 11 dhe 14, po pastaj zonja Haxhiu, i votojmë të gjitha një nga një. Urdhëro, zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Në rregull, kryetar!

Propozimi i dytë, te shërbimi shëndetësor i punës, që nënkupton organin kompetent për të kryer mbikëqyrjen mjekësore të punonjësve të ekspozuar, kapaciteti i të cilit për të punuar në këtë drejtim është i njohur nga agjencia, propozimi im është: Shërbimi Shëndetësor i Punës nënkupton Institucionin Shëndetësor Publik të nivelit terciar dhe fushëveprimtaria e Mjekësisë së Punës për të kryer mbikëqyrje mjekësore të punonjësve të ekspozuar, kapaciteti i të cilit për të punuar në këtë drejtim është i njohur nga vetë agjencia.

Propozimi i tretë, detyrat dhe përgjegjësitë e agjencisë formulohen ose propozohen kështu: siguron mbështetje financiare për institucionin publik, shërbimin teknik dhe shëndetësor të punës për furnizimin me pajisje, aparaturë moderne të nevojshme dhe mbi përmbajtjen e tyre, si dhe sigurimin e ekspertëve.

Dhe, tani rekomandimi i katërt ose propozimi i katërt te neni 11, pika 2. Shërbimet dhe ekspertët e mëposhtëm janë subjekt i njohjes nga agjencia. Propozimi im është vetëm te pika 2. 2. Shërbimet e Mjekësisë së Punës – Institucioni Publik i Mjekësisë së Punës, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës.

Propozimi i pestë, te neni 12, te matjet. Matjet, siç janë vlerësimi i shkallës së dozës, caktimi i përqendrimit të radionukleideve në mostra, vlerësimi i dozës, radoni në hapësirë të brendshme ose identifikimi i tyre duhet të kryhen nga organizatat e akredituara. Rekomandimi im është: matjet, siç janë vlerësimi i shkallës së dozës, caktimi i përqendrimit të tyre në mostra, vlerësimi i dozës, radoni në hapësirë të brendshme ose identifikimi i tyre duhet të kryhen nga institucionet e akredituara publike nga fushëveprimtaria e Mjekësisë së Punës.

Dhe, propozimi i gjashtë ose i fundit, te neni 21, mbikëqyrja mjekësore e punonjësve, paragrafi 1. Ndërmarrja siguron mbikëqyrjen mjekësore nga shërbimi i njohur i Mjekësisë së Punës për punonjësit e ekspozuar, nën dy, sigurimin e klasifikimit mjekësor për punonjësit dhe rekomandimi im është: ndërmarrja siguron mbikëqyrjen mjekësore nga Institucioni Publik i Mjekësisë së Punës. Prandaj edhe një herë e di që ka rënë përqendrimi, por vërtet kërkoj mirëkuptimin, ngase jemi në përmbajtje të ligjit dhe nuk është se këto propozime e çrregullojnë ligjin, por përkundrazi, i japin kuptim më të plotë, ngase vërtet janë propozime të mia, por të punuara nga ekspertët e fushës. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, a i vendosim të gjitha përnjëherë në votim? Atëherë, mirë.

Amendamenti 4, deputetja Teuta Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, njëjtë po ashtu, amendamenti 8, amendamenti 10, amendamenti 11 dhe amendamenti 14.

Kolegë deputetë, përgatituni për votim, votojmë tash!

Të nderuar, u drejtohem veçanërisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare, ne jemi në një situatë kur, po 59 edhe 2, 60, duhet 61, me dorë, apo me dorë 3 vota, atëherë jemi 61. A janë 61 në sallë? 62 janë në sallë, po ne qenkemi 62. A nuk ke dashur të votosh? S'i ka bërë teknika, atëherë me dorë. A janë votat e këtyre katër deputetëve, të provojmë edhe një herë?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, po urdhëro, zonja Gaxherri?

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Unë po flas pasi që kryetari i komisionit mungon, në cilësinë e nënkryetares së komisionit. E po e shoh që është shpërqendrimi i madh, unë kam shumë respekt për zonjën, për amendamentet punën e saj që e ka bërë, kini parasysh, komisioni e ka ngritur komisionin punues në krye me kolegun i cili prezantoi mendimin e komisionit, kemi punuar me ekspertë, ky ligj është ligj, i cili unë jam i sigurt që asnjë deputet nuk ka ekspertizë brenda kësaj salle, sepse është ligj shumë specifik, andaj kolegë të nderuar, ju lutem, t'i votoni këto amendamente kundër. Mos ta bastardojmë ligjin tash.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi procesin e votimit, amendamentet e përmendura më herët para procesit të votimit paraprak, për arsye se s'pati kuorum, votojmë tash.

61 deputetë kanë votuar, 24 për, 29 kundër, 8 abstenime. Nuk kalojnë!

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!
Faleminderit!

Kanë votuar 63 deputetë. 63 për. S'ka kundër. S'ka abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin Nr. 06/ L- 029 mbi mbrojtjen nga rrezatimet dhe siguria bërthamore.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse ne pjesën e debatit e kemi kryer në komision parlamentar, do të jem shumë i shkurtër. Ne i kemi 23 amendamente, propozoj që t'i votojmë të gjitha, sepse kanë marrë mbështetjen e të gjitha partive politike.

KRYETARI: Faleminderit!

23 amendamente, shkojmë në votim të përbashkët. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar, 64 deputetë, të gjithë, janë për. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e propozuara. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar. 63 për. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

U miratua ligji.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit Nr. 06/L-037 për metrologji

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj zonjën Sala Berisha-Shala në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: Të nderuar deputetë,

Në përputhje me vendimin e Kuvendit që të shqyrtohen projektligjet që parashihen me agjendën e ERA-s, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim

Rajonal, bazuar në Rregulloren e Kuvendit në disa mbledhje të mbajtura shqyrtoi Projektligjin për metrologji, të propozuar nga Qeveria.

Për këtë projektligj komisioni ka miratuar 19 amendamente, të gjitha janë mbështetur nga komisioni, debatin e kemi shterë në komision. Prandaj, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 vendosi që Kuvendit t'i paraqes këtë rekomandim: të miratohet raporti me rekomandime lidhur me Projektligjin për metrologji.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, i votojmë të gjitha amendamentet, nga 1 deri 19 bashkë. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar. 60 për. 2 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohen amendamentet e propozuara, të gjitha, nga Komisioni Funkcional.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar. 64 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin Nr. 06/L- 037 për metrologji.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, zonjën Sala Berisha-Shala, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!

Edhe te raporti me rekomandime lidhur me këtë projektligj, komisioni i ka hartuar katër amendamente, mirëpo dua të ju njoftoj se te amendamenti 9 kemi marrë një propozim nga ministria, që komisioni është dashur ta riformulojë amendamentin 9. Ky amendament nuk ka kaluar nëpër procedurë në komisione të përhershme, sepse sot e kemi miratuar dhe është amendament teknik, që lidhet me nenin 16, paragrafi 2. Pra, vetëm është fjala “mund” zëvendësohet me fjalën “duhet”. Deputetë, kërkoj që ta miratoni këtë raport me rekomandime duke përmirësuar shprehjen në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Imet Rrahmani ka kërkuar fjalën. Bëhet gati Haxhi Avdyli. Nuk është, a? Atëherë, a shkojmë drejt në votim? Po më vjen keq tash pak... A kemi kuorum? Atëherë, në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 14 amendamente. I votojmë në tërësi 14 amendamentet. Votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë. 62 për, asnjë kundër, 1 abstenim. U miratuan amendamentet e propozuara.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar, 63 për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-041 për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Më lejoni veç të bëjë për opinionin publik, por është edhe për ju, kolegë deputetë. Për 63 ditë, të gjitha të plota, kemi kaluar 25 ditë në Kuvend. 63 ditë, 25 i kemi kaluar në Kuvend edhe në qoftë se, i kryejmë edhe dy ligje që i kemi pas këtij edhe dy projektligje, janë 22 ligje që i kemi kaluar. Është mirë për hir të opinionit publik.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, zonjën Sala Berisha-Shala që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar edhe këtë projektligj dhe ka miratuar 14 amendamente. Të gjitha janë me mbështetjen e komisionit. Debatet janë zhvilluar dhe shteruar në komision. Ju ftoj t'i votoni këto amendamente dhe projektligjin në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: 14 amendamente janë. Të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. I votojmë të gjitha bashkërisht. Votojmë tash!

Armendi voton me dorë.

63 deputetë kanë votuar. 62 në mënyrë elektronike 1 me dorë, 63 janë për, të gjithë.

Shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 65 për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, zonjën Sala Berisha-Shala, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Shërbimi Gjeologjik është një institucion i rëndësishëm në Kosovë, që ka për detyrë t'i rekomandojë Qeverisë që ta bazojë zhvillimin ekonomik në resurse minerale. Këtë projektligj e ka shqyrtuar Komisioni për Zhvillim Ekonomik, ka miratuar 14 amendamente. Debatimi është shteruar në komision. Në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2018 vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këto rekomandime:

- të miratohet raporti lidhur me Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 14 amendamente. I votojmë të gjitha bashkërisht. Votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar. 66 kanë votuar për.

Miratohen të gjitha amendamentet pa shkuar që ta votojmë tekstin e projektligjit në tërësi.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim të Projektligjit me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar. 64 për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Unë ju kisha dhënë një propozim. Në qoftë se dëshironi, e hedh në votim. Ju keni qëndruar deri në fund. Unë kisha dhënë propozim, në qoftë se doni ta hedhim në votim, që t'u largohen mëditjet deputetëve që nuk kanë qenë të pranishëm në këtë seancë.

A dëshironi që kryetarët e grupeve parlamentare të tregojnë qëndrim? Kolegë deputetë, a dëshironi të votoni? Bilall Sherifi ka kërkuar fjalën. Do t'i pyes grupet parlamentare.

BILALL SHERIFI: Kryetar, të gjithëve, jo nuk mendoj që duhet t'i hiqet mëditja askujt, sepse të gjithëve mund të na ndodhë një herë të jemi, e herën tjetër të mos jemi. Rëndësi ka që çdoherë të jemi së paku 61, që të mund të marrim vendime.

KRYETARI: Tash, në emër të LDK-së, Arben apo Armend? Arben Gashi, urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Nuk kemi të drejtë ne që të gjykojmë pse dikush nuk është në sallë dhe pse mungon në seancë. Është vendim politik ndoshta pse dikush mungon dhe është e padrejtë që ne ta gjykojmë dhe ta ndëshkojmë financiarisht dikë. Nuk e kemi këtë të drejtë. Seanca nuk mund ta marrë këtë lloj vendimi. Unë gjykoj që është i padrejtë dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së nuk e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Seanca ka të drejtë të marrë çdolloj vendimi, ta kini parasysh, vetëm unë nuk kam të drejtë vetë. Unë s'kam të drejtë, por seanca ka të drejtë. Atëherë, Glauk Konjufca nga "Vetëvendosja" dhe Ahmet Isufi nga AAK-ja, si dhe Memli Krasniqi nga PDK-ja.

GLAUK KONJUFCA: Unë nuk mendoj se kjo çështje zgjidhet me një votim të thjeshtë këtu në seancë, por duhet të gjejmë metoda, megjithatë jam ithtar i mendimit se do të gjejmë mekanizma të cilat e ngrenë me ca sanksionime disiplinën dhe, le të themi, atë përkushtimin e punës që e kemi marrë këtu në Kuvend të Republikës së Kosovës. Kështu që unë do të kisha propozuar që ndoshta... ndonjë mekanizëm i Administratës, ta zëmë, ta shikojë për secilin deputet për nga përqindja e pjesëmarrjes së kohës nëpër seanca, sepse nëse e lëmë edhe kështu, që deputeti mjafton ta hedhë nënshkrimin në orën 10:00 dhe pastaj shkon nëpër punët e veta, dhe kjo nuk më duket në rregull.

Kështu që nuk mund të pajtohem fare me deputetin i cili vjen këtu në orën 10:00, e hedh një nënshkrim dhe pastaj nuk vjen tërë kohën, ndërsa e merr mëditjen në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Unë mendoj se Administrata duhet ta ketë një mekanizëm, që nëse na tregon se ka këso rastesh, atëherë unë jam që ato raste të penalizohen.

KRYETARI: Pikërisht për këtë arsye e shtrova si shqetësim. Në këtë radhë e merrni ju vendimin si seancë, kurse radhëve tjera e futni në Rregullore. Ka shumë raste kur po vijnë në orën 10:00, vetëm nënshkruhen, rrinë gjysmë ore dhe pastaj largohen. Kjo është... ka shumë raste.

Atëherë, Ahmet Isufi, Memli Krasniqi dhe Dardan Sejdiu dhe votojmë. Ahmet Isufi, urdhëro!

AHMET ISUFI: Zoti kryetar!

Kjo çështje duhet të rregullohet me Rregullore dhe jo në disa seanca të mungojnë e të mos dënohen, ndërsa në një seancë të dënohen. Kjo nuk është në rregull. Prandaj, ose duhet të sanksionohet me Rregullore, ose kështu të mos merret vendim.

KRYETARI: Zoti Isufi, do të ishte shenjë e mirë për Rregulloren e re sot të votojmë. Unë jam ithtar. Zoti Krasniqi dhe zoti Sejdiu e kanë fjalën në emër të grupeve parlamentare dhe shkojmë në votim.

MEMLI KRASNIQI: Unë po të mundja do ta përsërisja fjalën time në seancën e para një jave, kur e kemi pasur të njëjtën situatë. Edhe atë ditë kam qenë në favor të sanksionimit, në mungesë të mundësive tjera, financiar të deputetëve, të cilët, e kam thënë edhe atë ditë, pa arsye mungojnë dhe ka shumë të tillë, në gjithsecilin grup parlamentar, që thjesht nuk e respektojnë mandatin që kanë marrë prej qytetarëve dhe që kanë obligim të qëndrojnë këtu deri në fund, siç po qëndrojmë shumë prej nesh, por që kanë prioritetë tjera. Kur u kalon fushata zgjedhore dhe pasi ta marrin mandatin... Edhe atë ditë kam propozuar që duhet, meqenëse e kemi kaluar në lexim të parë Rregulloren që ta përfshijmë këtë mundësi të sanksionimit nëpërmjet Rregullores.

Ne sot mund të votojmë, zoti kryetar, edhe për ta dhënë një shembull, një simbolikë, nuk e zgjidhim çështjen, sepse s'mund të votojmë në secilën seancë. Unë edhe atë ditë kam propozuar që nënshkrimi i pjesëmarrjes në seancë, i mënngjesit kur fillon seanca, të mos jetë baza për pagesën e mëditjeve, por që ta kemi fillimin, ta kemi pauzën, ta kemi fundin dhe vetëm ata të cilët realisht qëndrojnë gjithë ditën këtu, ta kenë mundësinë që të kenë kompensim financiar.

KRYETARI: Para se të flasë zoti Sejdiu, Administrata nuk mund ta bëjë këtë, as kryetari, ta kini parasysh, mundeni ju nëpërmjet Rregullores së re. Kjo për të ardhmen po flas. Për sot, është vendim ideal. Zoti Sejdiu, qëndrimi edhe i grupit tuaj dhe shkojmë në votim. Ju e vendosni vetë.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Ky lloj diskutimi i shërben dukjes së mirë karshi opinionit, që po brengosemi për mungesën e deputetëve të tjerë. Në fakt, ajo që duhet të jetë brengosëse është mosgatishmëria e deputetëve që të merren me politikëbërje. E pra, këtë mosgatishmëri duhet ta shpërfaqim para opinionit në mënyra tjera, pra me pjesëmarrjen apo jo të tyre pas çdo seance, kush ka qenë pjesëmarrës e kush jo dhe kështu qytetarët të vendosin se një deputet a meriton të jetë në sallë, apo jo.

Diskutimi nëse duhet të paguhet një deputet apo jo, sepse s'ka qenë në sallë, është thjesht diskutim për sytë e opinionit. Edhe po të vijnë që të gjithë këtu dhe prapë 20 prej tyre diskutojnë, ndërsa 100 tjerë të jenë makinë votimi, e marrin mëditjen, mendim nuk japin, politika vazhdon të jetë e vobektë. Pra, të jemi më të hapur karshi qytetarëve, të vlerësojnë, të shohin qytetarët kush ka qenë në sallë, kush ka diskutuar, çka ka diskutuar, kush ka votuar... dhe, kështu atëherë ata do të jenë përgjegjës për politikën që themi këtu, e sponsorizojnë qoftë me nisma legislative, qoftë me amendamente, apo me çfarëdo veprimi tjetër politik në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Është në dorën tuaj. Propozimi është shumë konkret. Do t'u hiqet mëditja të gjithë deputetëve që nuk janë aktualisht prezentë në sallë, në qoftë se ju votoni për. Votoni tash, kush është për, kundër, abstenim? Votojmë tash!

Kjo është ajo që ishte. S'ka gatishmëri të votimit. Megjithatë, faleminderit juve që ishit të pranishëm deri më tani për kontributin.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*